



Instituti për të drejtat e njeriut



MANUAL PËR

STANDEDET EVROPIANE PËR PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

standardet e Këshillit të Evropës dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për procedurat administrative



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Titulli:

Manual për standardet evropiane për procedurat administrative – standardet e Këshillit të Evropës dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për procedurat administrative

Titulli original:

Прирачник за европските стандарди за управните постапки – стандарди на Советот на Европа и на Европскиот суд за човекови права за управните постапки

Botues:

Instituti për të Drejtat e Njeriut

Për botuesin:

Margarita Caca Nikollovska

Redaktor:

dr. Vesna Stefanovska

Autorë:

Konstantin Bitrakov

Martin Sopronov

Përktheu:

Blerina Starova Zllatku

Dizajn grafik:

Damjan Kanzurov

Shkup, 2023

Ky botim është përpiluar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij nuk pasqyron në asnjë mënyrë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

35.077.3:[341.24:341.176(4)](035)

35.077.3:341.645.5(44)(035)

BITRAKOV, Konstantin

Manual për standardet evropiane për procedurat administrative [Електронски извор] : standardet e Këshillit të Evropës dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për procedurat administrative / [autorë Konstantin Bitrakov, Martin Sopronov]. - Скопје : Институт за човекови права, 2023

Начин на пристапување (URL): <https://ihr.org.mk/al/publikime>. - Превод на делото: Прирачник за европски стандарди за управните постапки : стандарди на Советот на Европа и Европскиот суд за човекови права за управните постапки / Константин Битраков, Мартин Сопронов. - Текст во PDF формат, содржи 31 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 03.08.2023. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-5032-01-3

1. Sopronov, Martin [автор] а) Управна постапка -- Совет на Европа -- Регулатива -- Прирачници б) Управна постапка -- Европски суд за човекови права -- Прирачници

COBISS.MK-ID 61106693

Përmbajtja

I. HYRJE: SYNIMI DHE QËLLIMI I MANUALIT	4
II. PARIMET DHE STANDARDET THEMELORE NË PROCEDURËN ADMINISTRATIVE	6
1. Ligjshmëria	6
2. Siguria juridike	9
3. Barazi, paanshmëri, objektivitet	10
4. Proporcionaliteti	12
5. Transparenca dhe llogaridhënia	15
6. Mbrojtja juridike	15
7. Standarde dhe parime të tjera	19
III. STANDARDE QË U REFEROHEN FUSHAVE TË VEÇANTA (TË DREJTAT SOCIALE)...	21
1. Praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor	21
2. Praktika e Gjykatës Evropiane të të drejtave të Njeriut për të drejtat e mbrojtjes sociale	22
3. Standardet në lidhje me të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor dhe të drejtat e mbrojtjes sociale	22
4. Rishikimi i disa rasteve në fushën e të drejtave sociale kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut	24
FRAGMENTE NGA RASTET MË TË RËNDËSISHME TË CITUARA	26

HYRJE: SYNIMI DHE QËLLIMI I MANUALIT

Marrë parasysh shkallën e sotme të zhvillimit të mendimit teorik, pothuajse nuk ka nevojë të shpjegohet në veçanti se administrata publike (në kuptimin më të gjerë të fjalës) çdo ditë ndikon në cilësinë e jetës së individëve, por edhe në zhvillimin e përgjithshëm të një shteti dhe/ose bashkësie lokale. Administrata publike perceptohet si mjete më i rëndësishëm i zbatimit të politikave shtetërore brenda vendit.¹ Ajo kryen veprimtari të shumëfishta,² e në kuadër të njëres prej tyre (e quajtur ‘zgjdhja e çështjeve administrative’) zbaton procedura administrative në të cilat:

- miraton akte të veçanta administrative (zakonisht të quajtura “vendime”) me të cila vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat ligjorë të qytetarëve;
- nxjerr akte reale me të cilat ndikon të drejtat, detyrimet dhe interesat ligjorë të qytetarëve, edhe pse me anë të tyre nuk vendos drejtpërdrejt për ta;
- ndërmerr veprime të tjera administrative që ndikojnë të drejtat, detyrimet dhe interesat ligjorë të qytetarëve.

Domethënë, që qytetarët të gëzojnë në mënyrë efektive një pjesë të të drejtave, ata së pari duhet të nisin një procedurë administrative dhe të marrin një akt administrativ specifik (vendim, licencë, leje, miratim). Për shembull, e drejta për siguri materiale për papunësi të përkohshme garantohet me Kushtetutën (neni 32) e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, në mënyrë që një qytetar të fitojë të drejtën në një rast specifik, kur ndodhet në një gjendje papunësie, i duhet të paraqesë një kërkesë në organin e administratës publike (Agjencia e Punësimit) dhe të marrë një akt administrativ me të cilit do t’i jepet ndihmë financiare të një shume të caktuar. Gjithashtu, detyrimet e qytetarëve përcaktohen, në një farë mase, nga Kushtetuta dhe rregulloret e përgjithshme. Për shembull, secili e ka për detyrë të paguajë tatim dhe detyrime të tjera publike dhe të marrë pjesë në përmbushjen e shpenzimeve publike (neni 33) Por shuma e taksës që qytetari duhet të paguajë përcaktohet nga një akt administrativ i lëshuar nga një organ administrativ (Drejtoria e të Ardhurave Publike).

Me kryerjen e procedurave administrative, administrata publike vendos për shumë të drejta dhe detyrime të tjera të individëve dhe personave juridikë, për të cilën një listë shteruese nuk do të ishte e mundur. Pa marrë parasysh nëse flasim për të drejtën për të ndërtuar në tokën e vet, detyrimin për të paguar doganën, të drejtën për të marrë një pension pleqërie ose një pension tjetër, të drejtën për të marrë një bursë, të drejtën për të importuar mall, të drejtën për të marrë azil, etj., administrata publike në një procedurë administrative miraton një akt (administrativ/real) ose do të ndërmarrë veprime administrative.

Për shkak rëndësisë të këtillë të procedurave administrative, janë vendosur standarde për zbatimin e tyre, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Këto standarde mund të ndikojnë në procedurat administrative në mënyrë direkte ose indirekte, më saktë, në vetë rregullimin e procedurave administrative nga ligjvënësi ose kur ato plotësohen me akte të përgjithshme të administratës, por edhe kur procedurat drejtohen nga autoritetet publike.³

Qëllimi i këtij Manuali është t’u kushtojë vëmendje disa prej standardeve ndërkombëtare të vendosura në nivel të Këshillit të Evropës. Në këtë mënyrë, mbi të gjitha, do të merren si shembull standardet që vijnë nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më poshtë: **KEDNJ ose Konventa**), e cila është

1 Давитковски Б., Павловска-Данева А. (2018). Административно право – прв дел (материјално право) – трето изменето и дополнето издание, Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, Скопје, пристапено преку: https://www.ukim.edu.mk/e-izdanija/PRF/Administrativno_pravo_1.pdf (последна посета на 31.5.2023), стр. 10.

2 Aktivitetet e administratës shpjegohen në detaje në: Ibid, gjendet në: https://www.ukim.edu.mk/e-izdanija/PRF/Administrativno_pravo_1.pdf (vizita e fundit më 31.05.2023), f. 249-267.

3 Termi “autoritet publik” është më i gjerë dhe përfshin: ministrinë, organet brenda ministrive (drejtoritë), organet e pavarura të administratës shtetërore që i përgjigjen Qeverisë (agjencitë etj) dhe organet e tjera shtetërore të pavarura që i përgjigjen Kuvendit (organet rregullatore, komisionet e pavarura etj), organet e komunave dhe Qytetit të Shkupit dhe të gjitha organet dhe organizatat e tjera me kompetenca publike (ndërmarrjet publike, institucionet etj.). Përkufizimi rrjedh nga Ligji për procedurën e përgjithshme administrative.

përpunuar në mënyrë më të detajuar, sa i përket administratës, në Rekomandimin CM/Rec(2007)7 për administrim të mirë?? të Komitetit të Ministrave⁴ dhe disa rekomandime të tjera, si dhe në praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (më poshtë: **GJEDNJ ose Gjykata**), kur interpretohet nëse autoritetet publike kanë kryer shkelje të nenit 14 të KEDNJ (ndalimi i diskriminimit), nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ (mbrojtja e pronës), si dhe standardeve të tjera relevante, nenit 8 (respektimi i jetës private) etj. Në mënyrë direkte do të përmenden edhe standardet për kontestin administrativ si një formë e kontrollit gjyqësor kundër akteve të administratës të sjella në procedurat administrative. Kjo do të rezultojë nga parimi i mbrojtjes ligjore në procedurën administrative, i cili në mënyrë të prerë thotë se duhet të ketë kontest administrativ. Kështu, do të përmendet edhe interpretimi i GJEDNJ-së në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së (gjykim i drejtë) dhe në korrelacion me nenet tashmë të përmendura, nenin 14, nenin 1 të Protokollit, por edhe me nenin 9 dhe nene të tjera. ⁵ Përveç standardeve evropiane (gjegjësisht, standardet e Këshillit të Evropës), ky Manual do t'i kushtojë vëmendje edhe parimeve të zhvillimit të procedurave administrative që dalin nga Ligji maqedonas për procedurën e përgjithshme administrative.⁶

Në këtë Manual, i kushtohet vëmendje e veçantë standardeve që vlejné në rastet kur merren vendime për të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor, sigurimit shëndetësor dhe të drejtat e tjera sociale. Manuali është i destinuar për çdo qytetar që është palë në një procedurë administrative ose kontest administrativ, si dhe për zyrtarët që zhvillojnë procedura administrative, dhe në fund të fundit për gjyqtarët e gjyqësorit administrativ.

4 Gjendet në: <https://rm.coe.int/cmrec-2007-7-of-the-cm-to-ms-on-good-administration/16809f007c#:~:text=By%20proposing%20a%20%E2%80%9Ccode%20of,all%20public%20administrations%20should%20use>. (vizita e fundit më 31.5.2023).

5 Gjendet në: https://www.echr.coe.int/documents/convention_mkd.pdf (vizita e fundit më 31.5.2023). Këto Rekomandime janë përmendur edhe nga Milovanovic D. Kristic I. gjatë përcaktimit të standardeve që u referohen autoriteteve publike dhe gjykatave administrative. (2021). Стандарди европског суда за људска права од значаја за управни суд, Управни суд и Правосудна академија, Београд, gjendet në: <https://www.pars.rs/images/biblioteka/Upravno-pravo/Standardi-Evropskog-suda-za-ludska-prava.pdf> (posledna poseta na 31.5.2023), стр. 16.

6 Gazeta zyrtare nr. 124/15.

II.

PARIMET DHE STANDARDET THEMELORE NË PROCEDURËN ADMINISTRATIVE

1. LIGJSHMËRIA

Parimi i ligjshmërisë është parimi themelor i procedurës administrative, gjegjësisht shtylla kryesore e rendit ligjor.⁷ Nëse shikojmë dokumentet e Këshillit të Evropës, një përkufizim gjithëpërfshirës i parimit të ligjshmërisë mund të gjendet në nenin 2 të Rekomandimit CM/Rec(2007)7:⁸

Rekomandimi CM/Rec(2007)7

Neni 2 - Parimi i ligjshmërisë

1. Autoritetet publike do të veprojnë në përputhje me ligjin. Ata nuk do të marrin masa arbitrare, madje as atëherë kur ushtrojnë kompetenca diskrecionale.
2. Autoritetet publike duhet të respektojnë të drejtën vendore dhe ndërkombëtare, si dhe parimet e përgjithshme ligjore që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e tyre.
3. Autoritetet publike do të veprojnë në përputhje me rregullat që përcaktojnë kompetencat dhe procedurat e tyre.
4. Autoritetet publike duhet të ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm kur, në bazë të një situatë faktike të përcaktuar, ligji në fuqi u jep atyre të drejtën për ta bërë këtë dhe kur ata justifikojnë qëllimin për të cilin janë caktuar.

Parimi i ligjshmërisë në përgjithësi ka një shtrirje të gjerë, gjegjësisht qëllimi i tij është të kufizojë fuqinë e autoriteteve publike dhe t'i parandalojë veprimet e tyre arbitrare. Autoritetet publike nuk mund të miratojnë akte administrative të kundërligjshme, gjegjësisht të ndërmarrin veprime administrative jashtë kompetencave të tyre. Apo thënë ndryshe, arsyeja për të cilën autoritetet publike përdorin kompetencat e tyre duhet të korrespondojë me arsyen për të cilën janë dhënë këtë kompetenca me ligj⁹. Ka dy shembuj në këtë drejtim. Njëri është *Prokopovich v. Russia*, ku një aplikanti në GJEDNJ i është konfiskuar apartament shtetëror që i është dhënë në përdorim. Apartamenti i është dorëzuar një personi tjetër. GJEDNJ konstatoi se administrata nuk kishte pasur bazë ligjore për këtë konfiskim, kështu që bëhej fjalë për shkelje të parimit të ligjshmërisë.¹⁰ Nga ana tjetër, në çështjen *Xintaras v. Sweden* GJEDNJ ka vlerësuar se konfiskimi i patentës së shoferit të aplikantit nuk është shkelje e parimit të ligjshmërisë, sepse ajo ka një bazë ligjore dhe është në përputhje me interesin publik të shoqërisë suedeze, ndërkohë që ekziston gjithashtu një "ekuilibër i drejtë" midis interesit të tillë publik dhe interesit privat¹¹ (për këtë "ekuilibër të drejtë", gjegjësisht, parimin e proporcionalitetit do të flasim më poshtë).

Në teori, parimi i ligjshmërisë ka dy aspekte, ligjshmëria formale dhe ligjshmëria materiale.¹² Ligjshmëria formale nënkupton detyrimin e autoriteteve publike gjatë miratimit të akteve konkrete administrative

7 Давитковски Б., Павловска-Данева А. (2020). Административно право – книга втора (процесно право), Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, Скопје, gjendet në: https://www.ukim.edu.mk/e-izdanija/PRF/Administrativno_pravo_II.pdf (vizita e fundit më 31.5.2023), fq. 12.

8 Përkthimi i këtij neni dhe neneve të tjera të Rekomandimit është bërë nga autori, nga anglishtja në maqedonisht.

9 "Udhëzues: Administrata dhe ti" gjendet në <https://book.coe.int/en/international-law/7713-the-administration-and-you-a-handbook.html> (vizita e fundit më 31.05.2023), f. 10

10 Ibid, f. 10.

11 Ibid, f. 10.

12 Давитковски Б., Павловска-Данева А. (2020). Административно право – книга втора (процесно право), Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, Скопје, gjendet në: https://www.ukim.edu.mk/e-izdanija/PRF/Administrativno_pravo_II.pdf (vizita e fundit më 31.05.2023), fq. 12.

(vendime, licenca, miratime etj.) për të respektuar formën dhe procedurën e përcaktuar me ligj. Ligjshmëria materiale, nga ana tjetër, do të thotë që aktet administrative konkrete përmbajtjesore duhet të jenë në përputhje me ligjin. Kjo rrjedh edhe nga neni i mësipërm, nga Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Konkretisht, ligjshmëria formale parashikohet në paragrafin (3), ndërsa ajo materiale në paragrafët e tjerë.

Parimi i ligjshmërisë përmban brenda vetes një komponent të rëndësishëm, dhe kjo është parashikueshmëria.

Për të qenë në gjendje të themi se parimi i ligjshmërisë respektohet në kuptimin e vërtetë të fjalës, është e nevojshme që, para se të fillojë vetë procedura administrative, rregulloret të jenë mjaft të qarta, të qëndrueshme dhe të sakta në mënyrë që personat në fjalë të mund të parashikojnë relativisht me saktësi pasojat juridike të veprimeve të tyre, si dhe rezultatit e procedurës.¹³ Kjo do të nënkuptonte një detyrim shtesë për autoritetet publike, jashtë procedurës administrative, në vetvete. Është detyrim që vazhdimisht të propozohen masa për përmirësimin e ligjeve. Me fjalë të tjera, nëse autoritetet publike përmes zbatimit të procedurave administrative detektojnë mospërputhje dhe paqartësi, të cilat përfundimisht çojnë në praktika të ndryshme, ata duhet të iniciojnë ndryshim të ligjeve (duke pasur parasysh që vetëm ligjvënësi mund t'i ndryshojë ato, por autoritetet publike bëjnë propozime përmes Qeverisë).

Domethënë, duhet të ndryshohet paradigma. Në vend që parimi i ligjshmërisë të trajtohet si zakonisht, vetëm si një kufi për autoritetet publike, është e nevojshme që ai të nënkuptojë edhe proaktivitetin e autoriteteve publike në korrelacion me sigurinë ligjore (një parim të cilin e përshkruajmë në tekstin e mëposhtëm).

Nga pikëpamja e qartësisë së ligjeve, gjegjësisht të parashikueshmërisë, GJEDNJ në këtë çështje *The Sunday Times v. The United Kingdom* madje ka vërtetuar se nuk mund të konsiderohet që një autorizim i caktuar i një autoriteti publik është "i përcaktuar me ligj" nëse formulimi nuk është mjaftueshëm i saktë për t'iu mundësuar qytetarëve të parashikojnë, në një masë të arsyeshme, se cilat rrethana dhe pasoja do të lindin nga veprimet e tyre të caktuara.¹⁴

Parimi i ligjshmërisë është përcaktuar edhe në Ligjin maqedonas për procedurën e përgjithshme administrative (neni 5), i cili përmban një komponent tjetër shtesë, i cili është detyrimi i autoriteteve që të jenë të kujdesshëm sa i përket zbatimit të barabartë të ligjeve. Brenda autoritetit publik, duhet mbajtur llogari vazhdimisht për praktikën e vendosur, në rastet me të njëjtën bazë ligjore dhe faktike. Nisur nga kjo, sidomos për organet që vendosin për të drejtat e personave në situata të cenueshme (veçanërisht në rastin e të drejtave sociale), duhet të mbahen rregullisht kolegji me për të biseduar për interpretimin e dispozitave të caktuara dhe uniformimin e praktikës.

Së fundi, disa fjalë për detyrimin e autoriteteve publike për të mos vepruar në mënyrë arbitrare edhe atëherë kur miratojnë akte diskrecionale (neni 2, paragrafi 1 i Rekomandimit të cituar më lart). Aktet diskrecionale janë ato akte që janë miratuar me vlerësim të lirë. Ndonjëherë vetë ligjet i lejojnë autoritetet publike që në situata të caktuara të vendosin: nëse do të kalojnë një akt të caktuar; nëse po, cila do të jetë përmbajtja e atij akti. Pra, aktet diskrecionale përmbajnë autoritetin që autoritetet publike të zgjedhin lirisht midis dy ose më shumë alternativave ligjërish të barabarta.¹⁵ Aktet diskrecionale miratohen vetëm kur ligjet i parashikojnë ato e në vendin tonë nuk ka një listë të vetme të të gjitha akteve diskrecionale të parashikuara në ligje. Sipas Rekomandimit të Komitetit të ministrave, edhe atëherë kur vendosin në mënyrë diskrecionale, gjë për të cilën janë të autorizuar ligjërish, autoritetet publike nuk mund të veprojnë në mënyrë arbitrare. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se:

- **autoritetet publike** do të miratojnë akte diskrecionale vetëm kur ato janë të autorizuar ta bëjnë këtë me ligj;

13 Paunio, E. (2009). Beyond Predictability – Reflections on Legal Certainty and the Discourse Theory of Law in the EU Legal Order, German Law Journal, vol. 10, no. 11, gjendet në: <https://germanlawjournal.com/volume-10-no-11/> (vizita e fundit më 31.05.2023), f. 1436.

14 Маггг nga: Миловановић Д., Крстић И. (2021). Стандарди европског суда за људска права од значаја за управни суд, Управни суд и Правосудна академија, Београд, gjendet në: <https://www.pars.rs/images/biblioteka/Upravno-pravo/Standardi-Evropskog-suda-za-ljudska-prava.pdf> (vizita e fundit më 31.05.2023), f. 16.

15 Давитковски Б., Павловска-Данева А. (2018). Административно право – прв дел (материјално право) – трето изменето и дополнето издание, Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, Скопје, gjendet në: https://www.ukim.edu.mk/e-izdanija/PRF/Administrativno-pravo_I.pdf (vizita e fundit më 31.5.2023), fq. 278.

- edhe pse aktet janë diskrecionale, ato duhet të kenë formën dhe përmbajtjen e parashikuar me ligj (hyrje, dispozitiv, arsyetim, udhëzim ligjor);
- nuk duhet të tejkalohe autorizim për vlerësim të lirë i dhënë me ligj;
- autorizimi nuk **mund të përdoret në kundërshtim me qëllimin për të cilin është dhënë**.¹⁶

Këto kufizime në aktet diskrecionale mund të shpjegohen me një shembull hipotetik. Supozoni se një kryetar i një komune ka të drejtë të japë ndihmë financiare për qytetarët e rrezikuar dhe ka lirinë të vlerësojë se kujt do t'i jepet ndihmë financiare dhe sa do të jetë shuma që do t'i japë secilit individ deri sa të shpenzohet zëri i buxhetit për ndihmë financiare. Kryetari i komunës duhet ta shfrytëzojë këtë autorizim për të arritur qëllimin për të cilin ai është dhënë – personat të rrezikuar të marrin ndihmë financiare në mënyrë ekspeditive dhe të shpejtë, pa pritur siç do të kishin pritur në rast se këtë ndihmë do ta kishin kërkuar nga organet qendrore, e jo për të marrë simpatinë e votuesve të mundshëm duke shpërdorur buxhetin komunal. Gjithashtu, duhet të jepen më shumë fonde për ata që kanë më tepër nevojë e jo për ata persona që kanë bindje më të përafërta me kryetarin e komunës.

PARIMI I LIGJSHMËRISË:	
<ul style="list-style-type: none"> ✓ veprimi në përputhje me ligjin dhe/ose me një marrëveshje të miratuar ndërkombëtare ✓ merret parasysh uniformiteti i praktikës së autoriteteve publike ✓ miratimi i kujdesëshëm i akteve diskrecionale ✓ autoritetet publike të iniciojnë ndryshime në ligje në rastet kur, përmes praktikës së tyre, ata vënë re se dispozitat janë konfuze ✓ autoritetet publike t'i ndryshojnë në mënyrë të pavarur aktet nënligjore të tyre me të cilat rregullohen dispozitat ligjore, në rastet kur ata vënë re se këto të fundit krijojnë konfuzion, gjegjësisht nuk janë mjaft të qarta dhe të sakta. 	<ul style="list-style-type: none"> ✗ nuk veprohet në kundërshtim me ndonjë ligj dhe/ose marrëveshje të miratuar ndërkombëtare ✗ në rastet me të njëjtën situatë ligjore dhe faktike, nuk miratohen akte të ndryshme administrative ✗ aktet diskrecionale mund të miratohen vetëm kur këtë gjë e lejon një ligj i caktuar. ✗ edhe atëherë kur lejohet miratimi i akteve diskrecionale, akti diskrecional nuk duhet të keqpërdoret – autoriteti publik duhet të vendosë lirisht vetëm për të arritur qëllimin për të cilin është përcaktuar vendosja e lirë, ta respektojë formën e aktit dhe procedurën për miratimin e tij.

¹⁶ Ibid, f. 280. Këto kufizime lindin edhe nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative.

2. SIGURIA JURIDIKE

Përveç parimit të ligjshmërisë, në Rekomandimin CM/Rec(2007)7 në nenin 6, siguria juridike përshkruhet si parim i veçantë.

Rekomandimi CM/Rec(2007)7

Neni 6 - Parimi i sigurisë juridike

1. Autoritetet publike veprojnë në përputhje me parimin e sigurisë juridike;
2. Autoritetet publike nuk mund të marrin asnjë masë papravepruese, përveçse në rrethana ligjrisht të justifikuara; Autoritetet publike nuk do të ndërhyjnë në të drejtat e fituara dhe në situatat ligjore të formës së prerë, me përjashtim të rasteve kur kjo është doemos e nevojshme për interesin publik.
3. Në raste të caktuara, sidomos kur vendosen detyrime të reja, mund të jetë e domosdoshme të parashikohen dispozita kalimtare ose të jepet një periudhë e arsyeshme për hyrjen në fuqi të këtyre detyrimeve.

Nisur nga kjo dispozitë, parimi i sigurisë juridike në praktikë pasqyrohet në më shumë mënyra.

Së pari, veprimi në përputhje me parimin e sigurisë ligjore do të thotë që autoritetet publike duhet të jenë të qëndrueshme dhe jo arbitrare në marrjen e vendimeve të tyre, dhe ligji duhet të formulohet qartë dhe të zbatohet në mënyrë të duhur.¹⁷ Pra, parimi i sigurisë ligjore kërkon parashikueshmëri – qytetarët të mund të presin në mënyrë të arsyeshme se cili do të jetë rezultati i çdo procedure. Megjithatë, që një parashikueshmëri e tillë të ekzistojë, praktika e autoriteteve publike duhet të jetë uniforme. Është e papranueshme që i njëjti autoritet publik të veprojë ndryshe në rastet që janë të njëjta. Por detyrimi për të vepruar në mënyrë të barabartë gjithashtu do të thotë që dy dhe/ose më shumë autoritete publike gjithashtu duhet të veprojnë në mënyrë të njëtrajtshme, në drejtim të ndërtimit të të ashtuquajturës praktikë administrative. Kështu, për ta ilustruar thjesht, dy komuna nuk mund të kenë praktika të ndryshme në çështje që janë të njëjta (baza të njëjtë ligjore për çështjen, si dhe situatë të njëjtë faktike). Kjo jo vetëm që është në kundërshtim me parimin e barazisë, i cili do të diskutohet më poshtë, por cenon besimin e publikut në administratën publike. Në nivelin e sektorit publik, nevojitet koordinim dhe harmonizim i shpeshtë.

Së dyti, si rregull, nuk duhet të lejohet anulimi i një akti konkret administrativ i autoritetit publik (i cili tashmë është në fuqi) sepse në këtë mënyrë shkelet siguria juridike, e sidomos nuk duhet të rrezikohen të drejtat tashmë të fituara të individëve. Anulimi, me përjashtim, do të ishte i mundur vetëm në rastet kur:

- akti origjinal është i paligjshëm dhe: (*) nëse nuk ka pritje legjitime që duhet të mbrohet; ose (*) nëse interesi publik për anulimin e aktit tejkalon të drejtën dhe interesin e individit që akti të mbetet;
- akti origjinal është i ligjshëm dhe: (*) nëse nuk ka pritje legjitime të individit që akti të mbetet; ose (*) nëse faktet dhe rrethanat përkatëse kanë ndryshuar në mënyrë që interesi publik tani tejkalon të drejtën dhe interesin për të lënë aktin në fuqi.¹⁸

Gjithashtu, kur merret vendimi për anulimin e një akti administrativ dhe për arritjen e një ekuilibri midis interesit publik dhe privat, duhet të kihet parasysh se akti mund të anulohet plotësisht ose pjesërisht. Pra, në këtë konotacion, kur akti anulohet, duhet të merret parasysh proporcionaliteti, gjegjësisht parimi i proporcionalitetit, për të cilin do të flasim në tekstin e mëposhtëm. Por kjo është më shumë në fushën e parimit të proporcionalitetit, për të cilin do të flasim më tej.

Autoriteti publik nuk duhet as t'i shfuqizojë aktet që tashmë janë përfundimtare dhe të zbatueshme, e as t'i anulojë ato.¹⁹ Nga ana tjetër, kur i shfuqizon, duhet të marrë parasysh interesat dhe pritshmëritë

17 Marrë nga: Миловановић Д., Крстић И. (2021). Стандарди европског суда за људска права од значаја за управни суд, Управни суд и Правосудна академија, Београд, gjendet në: <https://www.pars.rs/images/biblioteka/Upravno-pravo/Standardi-Evropskog-suda-za-ludska-prava.pdf> (vizita e fundit më 31.5.2023), f. 25

18 Të dyja pikat janë marrë nga: Ibid , f. 25.

19 Termat "anulim" dhe "shfuqizim" kanë një ndryshim thelbësor. Gjegjësisht anulimi i një akti gjithashtu shfuqizon të gjitha pasojat që ai ka prodhuar deri në momentin e anulimit të tij, që do të thotë se nevojitet një kthim në gjendjen origjinale (para se të ekzistonte fare akti). Shfuqizimi do të thotë se akti nuk do të prodhojë efekt ligjor nga momenti i anulimit e tutje, por pasojat tashmë të prodhuara nuk ndryshohen. Kjo rregullohet me nenin 125 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

legjitime të palëve. Në këtë drejtim, mund të përmendim si shembull rastin *Ryskovskyy v. Ukraine*.²⁰ Bëhet fjalë për një rast ku këshilli i fshatit (si organ i qeverisjes vendore) ka anuluar vendimin me të cilin i ka dhënë tokë palës, për shkak se vendimi ka qenë i gabuar. GJEDNJ ka theksuar se autoritetet publike duhet të kenë të drejtën të korrigojnë gabimet e herëpashershme në aktet e tyre administrative, edhe në rastet kur ato lindin nga neglizhenca e tyre, por se anulimi i një vendimi në çdo kohë, pa pjesëmarrjen e palës së përfshirë në vendim, si dhe pa kompensim, nuk duhet të lejohet.

Kur flasim për anulimin, gjegjësisht shfuqizimin e akteve (administrative), Ligji maqedonas për procedurë të përgjithshme administrative është modern dhe plotësisht i harmonizuar me standardin e sigurisë juridike që del nga dokumentet e Këshillit të Evropës. Këtë e shohim në Kapitullin XIV (Neni 122 – 125)²¹ ku anulimi/shfuqizimi i akteve rregullohet në përgjithësi kur nevojitet të mbrohet interesi publik në kuptimin më të gjerë të fjalës.²²

PARIMI I SIGURISË JURIDIKE:	
<ul style="list-style-type: none"> ✓ praktika uniforme e autoriteteve publike kur miratojnë të njëjtat akte administrative në rastet me të njëjtën situatë juridike dhe faktike ✓ kur përdoren mjete të jashtëzakonshme ligjore (shfuqizim/anulim i një akti administrativ), nevojitet të merret parasysh proporcionaliteti i detyrimeve të cilat i imponohen palës ✓ aktet të anulohen/shfuqizohen edhe pjesërisht e jo plotësisht, nëse kjo mjafton për ta mbrojtur interesin publik, me çka edhe palëve nuk do t'u imponohen detyrime të larta disproporcionale.²³ 	<ul style="list-style-type: none"> ✗ brenda kuadrit të veprimit të një autoriteti publik, nuk duhet të ketë praktikë jo-uniforme gjatë zgjidhjes së rasteve që, sipas bazës ligjore dhe faktike, janë të njëjta ✗ dallime nuk mund të ketë as atëherë kur bëhet fjalë për veprimin e më tepër autoriteteve publike, të cilat vendosi në rastet e njëjta (për shembull, organet e më shumë komunave) ✗ përdorimi i mjeteve juridike të jashtëzakonshme duhet të jetë një përjashtim

3. BARAZI, PAANSHMËRI, OBJEKTIVITET

Padyshim, parimi i barazisë është një nga parimet themelore në përgjithësi, i përcaktuar në KEDNJ dhe Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe që ka rëndësi të veçantë në kryerjen e procedurave administrative. Kjo përshkruhet në Rekomandimin CM/Rec(2007)7, dhe menjëherë pas tij paraqitet parimi i paanshmërisë.

Rekomandimi CM/Rec(2007)7

Neni 3- Parimi i barazisë

1. Autoritetet publike veprojnë në përputhje me parimin e barazisë.
2. Autoritetet publike do t'i trajtojnë personat privatë, që ndodhen në të njëjtën situatë, në të njëjtën mënyrë. Ato nuk do të bëjnë diskriminim midis personave private në bazë të gjinisë, prejardhjes etnike, besimeve fetare ose besimeve të tjera. Çdo ndryshim në trajtim do të justifikohet objektivisht.

20 Marrë nga: Миловановић Д., Крстић И. (2021). Стандарди европског суда за људска права од значаја за управни суд, Управни суд и Правосудна академија, Београд, gjendet në: <https://www.pars.rs/images/biblioteka/Upravno-pravo/Standardi-Evropskog-suda-za-ljudska-prava.pdf> (vizita e fundit më 31.05.2023), f. 27

21 Arsyeja se pse nuk i referohemi nenit 121 nuk është se në raste të tilla aktet ndryshohen ose anulohen nga autoriteti publik, por për shkak të padisë për kontest administrativ të ngritur paraprakisht, kërkesat e së cilës autoriteti publik i pranon.

22 Paqe publike, siguri publike, rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve etj.

23 Për shembull, nëse autoriteti publik vëren se me gabimin e një pale, për vite i ka paguar asaj ndihmë më të lartë financiare sociale nga ç'është dashur, ndërkohë që ajo nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë, asaj mos t'i kërkohej të paguajë shumën e plotë të ndihmës sociale që ka marrë gjatë viteve (një detyrim joproporcional), por vetëm të korrigohej shuma për të ardhmen. Më shumë për këtë do të flitet në kapitujt e mëposhtëm, te parimi i proporcionalitetit.

Neni 4 - Parimi i paanshmërisë

1. Autoritetet publike veprojnë në përputhje me parimin e paanshmërisë.
2. Autoritetet publike veprojnë në mënyrë objektive, duke marrë parasysh vetëm çështjet relevante.
3. Autoritetet publike do të veprojnë në mënyrë të njëanshme.
4. Autoritetet publike sigurojnë që zyrtarët e tyre publikë t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme, pavarësisht bindjeve dhe interesave të tyre personale.

Në përgjithësi, parimi i barazisë do të thotë që autoritetet publike nuk marrin vendime diskriminuese. Autoritetet publike duhet t'i interpretojnë ligjet në një mënyrë të tillë që të mos marrin vendime diskriminuese për qytetarët, gjegjësisht vendime që do t'i vënë ata në një pozitë të pabarabartë (përveç nëse kjo gjë është me interes më të gjerë dhe e justifikuar).

Për shembull, në një nga çështjet që i shtjellojmë në më shumë detaje në tekstin e mëposhtëm (*Kjartan Ásmundsson v. Iceland*) GJEDNJ tregon praktikën diskriminuese të autoritetit publik (Fondi pensional) sepse, pas miratimit të legjislacionit të ri, ai ndërpreu pensionin invalidor për vetëm 54 persona, ndërsa 689 personat e tjerë vazhdonin ta merrnin. Në korrelacion me parimet e tjera (proporcionaliteti), GJEDNJ këtu evidenton një trajtim ndryshe të pajustificuar. Ka pasur vendime të shumta të GJEDNJ-së në drejtim të ndalimit të diskriminimit, gjegjësisht në aspekt të parimit të barazisë.

Por kur flasim për barazinë dhe zbatimin e këtij parimi, autoritetet publike gjithashtu duhet të iniciojnë ndryshime në ligje (ose miratimin e ligjeve të reja) në rastet kur ata do të vënë re se vetë dispozitat ligjore janë të tilla, që i vendosin qytetarët në një pozitë të pabarabartë (pa qëllimin e ligjvënësit, për shkak të ndonjë lëshimi caktuar). Mund të bëhet fjalë për një keqkuptim të ligjit, një situatë në të cilën probleme të caktuara të praktikës nuk janë të rregulluara apo diçka e ngjashme. Në vijim, po ofrojmë një shembull:

Për një kohë të gjatë po flitet për problemet me të cilat përballen persona të caktuar që nuk kanë vendbanimin e tyre me nxjerrjen e kartave të identitetit.²⁴ Për çfarë bëhet fjalë? Ligji për paraqitjen e vendbanimit dhe vendqëndrimin të qytetarëve²⁵ parashikon se "vendbanimi është vendi ku qytetari është vendosur me qëllimin e banimit të përhershëm dhe ku ka *siguruar apartament për banim*", ndërsa konsiderohet se një apartament sigurohet nëse qytetari, ose një anëtar i familjes së tij, ka "një apartament të banueshëm në pronësi apo me kontratë qiraje" (neni 2). Ligji për letërnjoftim²⁶ parashikon që në letërnjoftim të regjistrohet edhe vendbanimi, ndërsa në aktet nënligjore përcaktohet që në kërkesën për lëshimin e letërnjoftimit të deklarohet vendbanimi (adresa). Pra, ligjet janë në thelb mjaft të ngurta, si pasojë paraqitet problem në rastin e lëshimit të letërnjoftimit për një person të pastrehë, domethënë një person që nuk ka siguruar një apartament për banim sipas përkufizimit të mësipërm. Ky problem po zvarritet tashmë për një kohë të gjatë dhe ka rezultuar në pasoja katastrofike për të pastrehët. Nga ana tjetër, Kushtetuta parasheh që çdo person nën moshën 18 vjeç ka detyrimin për të pasur letërnjoftim.

Autoritetet publike që lëshojnë letërnjoftime, në përputhje me parimin e barazisë, duhet të iniciojnë ndryshime në rregulloret (Ligjin për paraqitjen e vendbanimit dhe vendqëndrimin të qytetarëve dhe Ligjin për letërnjoftim), dhe të rregullojnë më tej çështjen e lëshimit të letërnjoftimit për personat që nuk mund të vërtetojnë se kanë siguruar apartament për të jetuar, andaj nuk kanë vendbanim. Për shembull, këtyre personave mund t'u lëshohet letërnjoftim në të cilën si vendbanim do të përcaktohet një qendër e caktuar për çështje sociale, ku qytetari do t'i dërgohet posta. Në këtë rast, edhe praktika e autoriteteve publike do të pajtohet me parimin e barazisë.

Inicimi i këtyre ndryshimeve në legjislacion është gjithashtu në përputhje me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore²⁷, sipas të cilit organet e administratës shtetërore "monitorojnë dhe janë përgjegjëse për situatën në fushat për të cilat ato janë themeluar", por edhe "japin iniciativë për zgjidhjen e çështjeve në fushat për të cilat ato janë themeluar" (neni 13).

24 Si shembull, shiko artikullin në vijim: <https://sdk.mk/index.php/glasno-za-ombudsmanot/drzhavata-ne-im-izdava-lichna-na-bezdomnitsi-gi-kaznuva-ako-nemaat/> (vizita e fundit më 31.05.2023).

25 Gazeta zyrtare nr. 36/92 ... 67/22.

26 Gazeta zyrtare nr. 08/95 ... 67/22.

27 Gazeta zyrtare nr. 58/2000...154/2019. Më shumë rreth monitorimit të situatave dhe ngritjes së iniciativave nga administrata publike mund të gjendet në veprat e lartpërmendura të autorëve Davitkovski B., Pavlovska-Daneva, A.

Sa i përket paanshmërisë, ajo është e qartë – persona të cilët janë në gjendje konflikti interesash në raste të caktuara nuk duhet të veprojnë dhe të vendosin.

Ligji për procedurën e përgjithshme administrative përmban parimin e barazisë, paanshmërisë dhe objektivitetit, në nenin 8 (si parim integral). Nëse shkojmë drejt një manifestimi konkret të parimit të paanshmërisë, nevojitet të merren parasysh dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative të cilat i referohen përjashtimit, më saktë neni 25.

Procedura e përjashtimit rregullohet në nenin 26, i cili parashikon që pala ose personi që ndodhet në gjendje konflikti interesash, paraqet kërkesë ose njoftim, gjë pas së cilës, eprori, gjegjësisht organi kolegjial, është i detyruar të marrë vendim jo më vonë se të nesërmen nga marrja e kërkesës, gjegjësisht njoftimit. Personi q; përjashtohet zëvendësohet menjëherë nga një zyrtar tjetër, e nëse kjo nuk bëhet, eprori merr përsipër përgjegjësinë për çështjen.

PARIMI I BARAZISË, PAANSHMËRISË, OBJEKTIVITETIT:	
<ul style="list-style-type: none"> ✓ autoritetet publike duhet t'i trajtojnë të gjitha palët në procedurë në mënyrë të barabartë. ✓ zyrtarët në autoritetet publike të cilët janë të autorizuar për drejtimin e procedurave administrative dhe marrjen e vendimeve, gjegjësisht funksionarët (nëse vendosin), përjashtohen sa herë që plotësohen kriteret ligjore. ✓ autoritetet publike duhet të iniciojnë ndryshime të ligjeve kur vënë re se në praktikë qytetarët vihen në pozitë të pabarabartë 	<ul style="list-style-type: none"> ✗ nuk merren vendime diskriminuese të asnjë forme ✗ zyrtarët nuk veprojnë nëse kanë një interes të caktuar financiar, personal ose ndonjë interes tjetër në këtë çështje

4. PROPORCIONALITETI

Parimi i proporcionalitetit është një tjetër parim i rëndësishëm që del si nga dokumentet e Këshillit të Evropës ashtu edhe nga legjislacioni i brendshëm e që zbatohet në punën e autoriteteve publike, gjegjësisht në kryerjen e procedurave administrative.

Rekomandimi CM/Rec(2007)7

Neni 5 – Parimi i proporcionalitetit

- 1.** Autoritetet publike do të veprojnë në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
- 2.** Autoritetet publike do të vendosin masa që ndikojnë të drejtat ose interesat e personave privatë vetëm aty ku është e nevojshme dhe në masën e kërkuar për arritjen e objektivit.
- 3.** Në ushtrimin e diskrecionit të tyre, autoritetet publike duhet të mbajnë një ekuilibër të përshtatshëm midis çdo efekti negativ që vendimi i tyre ka mbi të drejtat ose interesat e personave privatë dhe mbi qëllimin që ata kryejnë.

Çfarë do të thotë praktikisht proporcionaliteti? Sipas këtij neni të Rekomandimit të Komitetit të ministrave, është e nevojshme të arrihet një ekuilibër midis interesit publik (të cilin organi me aktin ose veprimin e tij e mbron) dhe interesit dhe/ose të drejtës së individit.

Proporcionaliteti vlerësohet nga rasti në rast. Megjithëse parimi është në dukje abstrakt, ai ka implikime praktike në procedura të ndryshme administrative.

Të japim një shembull nga vendi ynë:

Në drejtim të proporcionalitetit, gjegjësisht me qëllim që t'u lejohet autoriteteve publike më shumë hapësirë për vlerësimin e rrethanave individuale, Ligji i fundit maqedonas për kundërvajtje²⁸ parashikoi dispozita shumë më të hollësishme për matjen e sanksionit që do të përcaktohet dhe, nëse bëhet fjalë për gjobë, çfarë shumë do të ketë. Për shembull, kur shkelësi është një person fizik, duhet të merret parasysh shuma e pagës së tij, të ardhurat e tjera, prona, detyrimet familjare dhe gjëra të tjera të ngjashme (neni 16). Kështu, nëse një vepër penale është kryer nga një person i cili është në një gjendje të palakmueshme pronësore dhe financiare, autoriteti duhet ta marrë parasysh këtë fakt.

Një problem në Republikën e Maqedonisë së Veriut lind kur ligjet materiale, ku parashikohen kundërvajtje, nuk japin hapësirë për matje siç jep Ligji për kundërvajtje.

Le të ilustrjmë: Ligji i përmendur për kundërvajtje parashikon disa sanksione për personat fizikë që kanë kryer kundërvajtje, të tilla si: vërejtja, puna me interes të përgjithshëm, gjoba, pikët negative, ndërprerja e vlefshmërisë së patentës për shofer e të ngjashme. Gjithashtu, sa i përket vërejtjes, parashikohet që ajo të shqiptohet si një sanksion i pavarur kundërvajtës ose në këmbim të një gjobe, kur bëhet fjalë për një kundërvajtje të kryer në rrethana lehtësuese që e bëjnë atë veçanërisht të lehtë ose kur shqiptimi i saj arrin qëllimin e ligjit. Ligji për siguri në komunikacionin rrugor²⁹ nga ana tjetër, ku parashikohen kundërvajtje të veçanta, nuk e përmend vërejtjen në asnjë nga këto kundërvajtje, por përmend vetëm gjobat (me një shumë fikse). Kështu lind pyetja – çka nëse një shkelje e caktuar, e parashikuar në Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor është kryer nga një person që është në një situatë të pafavorshme financiare dhe që nuk mund të paguajë gjobën? A duhet që:

- Ministria e Punëve të Brendshme të vendosë një gjobë me një shumë fikse, duke marrë parasysh që Ligji për siguri në komunikacionin rrugor parashikon në mënyrë eksplicite shprehimisht atë sanksion për kundërvajtjen në fjalë, ose
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet ta zbatojë 'lex generalis', domethënë Ligjin për kundërvajtje, pra ta zëvendësojë gjobën me vërejtje?

Praktika tregon se autoritetet publike më së shpeshti i përmbahen zbatimit të rregulloreve materiale.?? Por nga pikëpamja e proporcionalitetit, në raste të tilla Ligji për kundërvajtje duhet të zbatohet direkt dhe duhet të lëshohet paralajmërim, edhe pse Ligji për siguri në komunikacionin rrugor nuk e parashikon këtë direkt si një mundësi (përkundrazi, parashikon një shumë fikse të gjobës për veprën në fjalë).

Parimi i proporcionalitetit është parashikuar edhe në Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, ku neni 6 përmban një dispozitë relativisht të ngjashme me atë në Rekomandimin CM/Rec(2007)7.

Për autoritetet publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe praktikën e tyre në të ardhmen rreth proporcionalitetit, është interesant rasti *Romeva kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut* ku GJEDNJ flet pikërisht për këtë parim. Siç mund të shihet nga Aneksi i këtij Manuali, bëhet fjalë për një çështje ku një personi fizik, në vitin 2000, iu dha e drejta e pensionit, por në vitin 2007, pas një auditimi të brendshëm, Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor përcaktoi se akti administrativ me të cilin është dhënë pensioni nga viti 2000 nuk ishte në rregull – duke pasur parasysh se kanë munguar prova rreth viteve të përvojës në një periudhë të caktuar (1963-1967), si pasojë nuk është plotësuar kushti për pension. Si rrjedhojë e kësaj, akti në vitin 2007, u revokua/anulua. Më vonë, u iniciua një procedurë për kthimin e pensioneve të paguara, në periudhën 2000-2007. Parashtruesja³⁰, pasi ka shteruar mjetet juridike në shtet, ka aplikuar në GJEDNJ. GJEDNJ, në vendimin e saj, i referohet pikërisht parimit të proporcionalitetit. Ajo arriti në përfundimin se qëllimi i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor për t'i rishikuar vendimet e veta dhe për të shfuqizuar një vendim të caktuar është i ligjshëm, duke marrë parasysh se bëhet fjalë për mbrojtje të fondeve publike. Megjithatë, GJEDNJ konstatoi se nuk ishte arritur proporcionalitet, ose siç u shpreh: "një ekuilibër i drejtë" midis interesit publik dhe interesave dhe të drejtave të palës, që do të thotë se barra mbi aplikanten ishte tepër e madhe. Pensioni nuk ishte ndërprerë (me efekt nga momenti i shfuqizimit e tutje), por vendimi u anulua, ndërsa nga parashkruesja u kërkua të kthejë pensionet e paguara, gjë e cila padyshim e ka vënë atë në një situatë jashtëzakonisht të vështirë financiare.

28 Gazeta zyrtare e RMV, nr. 96/19.

29 Gazeta zyrtare nr. 169/15 ... 122/2021.

30 I referohet aplikantes para GJEDNJ-së, jo në procedurë administrative.

Kështu, GJEDNJ-ja ka evidentuar shkelje të KEDNJ (më saktësisht të Protokollit 1 të saj). Mund të supozojmë se GJEDNJ do të kishte vendosur krejt ndryshe nëse vendimi i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor do të ishte anuluar vetëm nga ai moment kur është konstatuar si i gabuar, pa kërkuar nga aplikantja të shlyente shumën e plotë të marrë nga 2000 në 2007.

Pra, parimi i proporcionalitetit nënkupton edhe balancimin e vazhdueshëm të interesit publik dhe interesit të palës, domethënë të drejtave të saj. Është fakt se në një rast të tillë, në interesin publik është që të ndërhyhet në vendimin e marrë shumë vite më parë. Por a mund ta vendosë kjo gjë palën në një pozitë që të rrezikojë jetesën e saj? Nisur nga kjo, autoritetet publike duhet të jenë shumë të kujdesshme kur përdorin mjete ligjore të jashtëzakonshme. Për shembull, hipotetiki, nëse Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor kryen ndonjëherë një auditim dhe vëren se vite më parë ka nxjerrë një akt administrativ me të cilin ka dhënë një pension më të lartë se sa duhet, ai mund të vijojë dhe të shpallë aktin administrativ të pavlefshëm, në përputhje me nenin 124 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative. Kjo është në interesin publik, pra gabimi duhet të korrigohet, dhe vetë Ligji i sigurimit pensional dhe invalidor³¹ parasheh se “një vendim i formës së prerë me të cilin të siguruarit i njihet një e drejtë që, sipas rregulloreve të sigurimit pensional dhe invalidor, nuk i takon, me një vendim të ri shpallet i pavlefshëm, tërësisht ose pjesërisht”. Por në një rast të tillë, do të ishte më e përshtatshme të bëhet anulim i pjesës së aktit me të cilin është dhënë pensioni, e jo i plotë (shfuqizohet ajo pjesë në të cilën shuma e caktuar e pensionit tejkalon shumën e duhur). Përndryshe, përsëri do të ekzistonte rreziku që rastet të arrinin në GJEDNJ, pas shterimit të mjeteve juridike në gjykatat maqedonase, ku do të evidentohesh një shkelje e "ekuilibrit të drejtë", domethënë parimit të proporcionalitetit. Në veçanti, duhet të merret parasysh se cilat kanë qenë pritjet e ligjshme të palëve, si është gjendja e tyre financiare në atë moment dhe si do të ishte ajo nëse do t'u kërkohej të shlyenin fonde të mëdha etj.

Sa i përket proporcionalitetit, veçanërisht kur bëhet fjalë për pensionet dhe të drejtat e ngjashme, mund të përmenden dhe shumë çështje të tjera. Le të marrim si shembull çështjen *Moskal v. Poloni*.³² Aplikantja në vitin 2001, i ka kërkuar një institucioni përkatës për sigurim social në Poloni që të dilte në pension para kohe, sepse i duhej të kujdesej për fëmijën e saj të sëmurë. Kërkesa e saj u miratua, vendimi u mor dhe aplikantja filloi të përdorte pensionin e saj, dhe ka lënë punën. Një vit më vonë, autoriteti publik që i kishte dhënë më parë pensionin, e kishte revokuar sepse, sipas tij, dokumentacioni mjekësor i dorëzuar me kërkesën nuk ishte i mjaftueshëm. Pasi aplikantja kishte shteruar mjetet ligjore në shtetin e saj, ajo aplikoi në GJEDNJ, ku u evidentua shkelje e parimit të proporcionalitetit. Sipas GJEDNJ-së, tërheqja e vendimit të mëparshëm për të lejuar daljen në pension të parakohshëm e vë aplikanten në disavantazh disproporcional, veçanërisht duke marrë parasysh kujdesin për fëmijën.

Padyshim, edhe pse është relativisht e thjeshtë të përshkruhet se çfarë nënkupton proporcionaliteti, në praktikë ky parim kërkon një studim të hollësishëm të të gjitha fakteve dhe rrethanave përpara se të sillen ndonjë akt administrativ që shtron një detyrim ndaj individit (palës). Prandaj nevojiten trajnime për zyrtarët në organet publike, veçanërisht ato organe që vendosin për të drejtat sociale.

PARIMI I PROPORCIONALITETIT	
<ul style="list-style-type: none"> ✓ gjatë sjelljes së një akti administrativ që paraqet një detyrim, tregohet kujdes për të gjetur një ekuilibër midis mbrojtjes së interesit publik dhe detyrimit të imponuar. ✓ nëse objektivi mund të arrihet duke imponuar më pak detyrime ndaj palës, atëherë akti i tall sillet 	<ul style="list-style-type: none"> ✗ tregohet kujdes që palës të mos i imponohen detyrime të tilla që janë disproporcionalisht të mëdha, kundër interesit publik i cili mbrohet (pala të mos sillen në një gjendje ku i rrezikohet ekzistenca etj.)

31 Gazeta zyrtare nr. 98/12 ... 79/23.

32 Përshkrimi i çështjes gjendet në: Ciżyńska-Palosz, A. (2022). Participation of the Polish Parliament in the Execution of Judgments of the European Court of Human Rights, Problems of Law Journal, vol. 123(2022), gjendet në: https://ruj.uj.edu.pl/xmlui/bitstream/handle/item/298761/cizynska-palosz_participation_of_the_polish_parliament_2022.pdf?sequence=1&isAllowed=y (vizita e fundit më 14.6.2023), f. 156.

5. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Parimi i transparencës dhe llogaridhënies buron gjithashtu nga Rekomandimi CM/Rec(2007)7.

Rekomandimi CM/Rec(2007)7

Neni 10 - Parimi i transparencës

1. Autoritetet publike veprojnë në përputhje me parimin e transparencës.
2. Autoritetet publike do të sigurohen që individët privatë të informohen, nëpërmjet mjeteve të duhura, për aktivitetet dhe vendimet e tyre, të cilat mund të përfshijnë publikimin e dokumenteve zyrtare.
3. Autoritetet publike do të respektojnë të drejtën për qasje në dokumente zyrtare, në përputhje me rregullat që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale.
4. **Parimi i transparencës nuk rrezikon sekretet e mbrojtura me ligj.**

Parimi i transparencës mund të zbatohet sidomos në procedurat për qasje të lirë në informacione me karakter publik, përkatësisht në kryerjen e testit të dëmshmërisë, në përputhje me Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik³³ Testi i dëmshmërisë kryhet kur autoriteti publik (poseduesi i informatës) vëren se dhënia e informacionit të kërkuar mund të dëmtojë ndonjë të drejtë tjetër, për shembull të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale. Pastaj autoriteti kryen një test dëmshmërie (një lloj testi proporcionaliteti) përpara se ta refuzojë qasjen, në këtë mënyrë kontrollon pasojat mbi interesin i cili mbrohet, përkatësisht interesin që do të arrihej me publikimin e informatës kundrejt interesit publik që do të arrihej duke publikuar informacionin.

PARIMI I TRANSPARENÇËS	
<ul style="list-style-type: none">✓ autoritetet publike do t'i informojnë qytetarët për të gjitha çështjet relevante✓ autoritetet publike i mundësojnë qytetarit, i cili është palë në procedurë, qasje në dokumentacionin relevant për procedurën	<ul style="list-style-type: none">✗ nuk lëshohen të dhëna personale dhe/ose të dhëna të tjera që mund të shkaktojnë dëme për dikë nëse testi i dëmshmërisë tregon se ky dëm është më i madh se interesi publik që do të arrihej duke siguruar informacion (në procedurat për qasje të lirë në informacione me karakter publik).

6. MBROJTJA JURIDIKE

Një standard ose themel jashtëzakonisht i rëndësishëm mbi të cilin bazohet regjimi juridik i procedurës administrative është mbrojtja juridike. Në fakt, është një parim që flet për procedurat që pasojnë pas përfundimit të procedurës administrative, domethënë, pas miratimit të aktit administrativ konkret dhe/ose pas ndërmarrjes së veprimit administrativ. Me fjalë të tjera, legjislacioni i secilit shtet anëtar të Këshillit të Evropës duhet të ofrojë mbrojtje ligjore kundër akteve (konkrete) të miratuara në një procedurë administrative, si dhe kundër veprimeve administrative. Kjo rrjedh nga neni 6 i KEDNJ-së dhe rregullohet më tej nga Rekomandimi CM/Rec(2004)20.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6, paragrafi 1

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]

33 Gazeta zyrtare nr. 101/19.

Rekomandimi CM/Rec(2004)20

B. Parimet

1. Shtrirja e kontrollit gjyqësor

- a) Të gjitha aktet administrative duhet t'i nënshtrohen kontrollit gjyqësor. Ky kontroll mund të jetë i drejtpërdrejtë ose me përjashtim.
- b) Tribunali duhet të jetë i autorizuar për të shqyrtuar çdo shkelje të ligjit, duke përfshirë mungesën e juridiksionit, gabimet procedurale ose abuzimin e pushtetit.

1. Qasja në kontrollin gjyqësor

- a) Kontrolli gjyqësor duhet të jetë në dispozicion të të paktën personave fizikë dhe juridikë kur bëhet fjalë për aktet administrative që prekin drejtpërdrejt të drejtat dhe interesat e tyre. Shtetet anëtare inkurajohen të vlerësojnë nëse qasja në kontroll gjyqësor duhet të jetë e hapur edhe për shoqatat dhe personat dhe organet e tjera të autorizuara për të mbrojtur interesat kolektive ose të bashkësisë.
- b) Personat fizikë dhe juridikë mund të kushtëzohen nga shterimi i mjeteve juridike të parashikuara në legjislacionin nacional përpara procedimit për kontroll gjyqësor. Kohëzgjatja e procedurës për mjete të tilla juridike nuk duhet të jetë e tepruar.

Pra, është e nevojshme që, në përputhje me KEDNJ-në dhe Rekomandimin e cituar të Komitetit të Ministrave, të ketë kontroll gjyqësor mbi *çdo akt administrativ në veçanti*. Në mënyrë që të mos shkaktojë konfuzion, pika 1(a) thotë se kontrolli gjyqësor mund të jetë me përjashtim. Aludohet në shterimin e mjeteve të tjera juridike, dhe jo në atë se kontrolli do të ekzistojë vetëm me përjashtim.

Rekomandimi gjithashtu përmban dispozita të tjera të rëndësishme në lidhje me kontrollin gjyqësor, të përshkruara në pikat 3, 4 dhe 5.

Rekomandimi CM/Rec(2004)20

B. Parimet

1. Tribunal i pavarur dhe i paanshëm

- a) Kontrolli gjyqësor duhet të kryhet nga një tribunal i cili është vendosur me ligj dhe pavarësia dhe paanshmëria e të cilit është e garantuar në përputhje me kushtet e Rekomandimit Nr. R(94)12.
- b) Tribunali mund të jetë Tribunal administrativ ose pjesë e sistemit të rregullt gjyqësor.

2. E drejta për gjykim të drejtë

- a) Koha që i duhet gjykatës për të marrë një vendim duhet të jetë e arsyeshme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çdo çështjeje dhe hapat ose vonesat procedurale që u takojnë palëve, duke respektuar parimin e kontradiktoritetit.

Gjithashtu, në Rekomandimin e cituar të Komitetit të Ministrave CM/Rec(2004)20 përcaktohen dhe kushte të tjera në lidhje me kontrollin gjyqësor, sidomos në lidhje me kompetencat e gjykatës, barazinë e armëve dhe të ngjashme. Sa i përket efektivitetit të mbrojtjes gjyqësore, megjithatë, parashikohet një standard minimal me të cilin gjykata që kontrollon aktin administrativ duhet të ketë autoritetin, të paktën, të anulojë aktin dhe t'ia kthejë çështjen për vendim të serishëm autoritetit publik me udhëzime të caktuara. Gjithashtu, për t'u konsideruar efektive, mbrojtja gjyqësore duhet të jetë në gjendje të rezultojë me urdhër nga gjykata deri tek autoriteti publik për të ndërmarrë ndonjë lloj veprimi apo për të miratuar ndonjë akt (kjo është veçanërisht e rëndësishme kur ka heshtje nga ana e administratës).³⁴

³⁴ Heshtja e administratës nënkupton situatën kur pala paraqet kërkesë për fillimin e procedurës administrative, por autoriteti publik nuk miraton akt administrativ brenda afateve ligjore. Gjegjësisht, autoriteti publik ka 30 ditë për të miratuar një akt administrativ me kërkesë të palës, me mundësinë e zgjatjes së afatit në 60 ditë. Nëse autoriteti nuk e miraton aktin brenda afatit të caktuar, krijohet një trillim ligjor se kërkesa është refuzuar, gjë pas së cilës pala ka të drejtë të paraqesë mjete juridike sikur të kishte marrë një vendim refuzues. Më shumë për heshtjen e administratës në: Davitkovski B., Pavlovska-Daneva A. (2020). Административно право – книга втора (процесно право), Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, Скопје, gjendet në: https://www.ukim.edu.mk/e-izdanija/PRF/Administrativno_pravo_II.pdf (vizita e fundit më 31.5.2023), f. 49.

Kur bëhet fjalë për mbrojtjen ligjore kundër vendimeve dhe akteve të tjera konkrete administrative të miratuara në procedurë administrative, si dhe kundër veprimeve administrative, mund të thuhet se në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka pajtueshmëri të plotë me standardet evropiane nga pikëpamja e legjislacionit. Gjegjesisht, mbrojtja gjyqësore kundër vendimeve dhe akteve të tjera të miratuara në procedurën administrative ofrohet nga Gjykata Administrative, në shkallën e parë dhe Gjykata e Lartë Administrative, në shkallën e dytë. Kjo rrjedh si nga parimi i mbrojtjes ligjore, i parashikuar në nenin 14 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, ashtu edhe nga Ligji për konteste administrative.³⁵ Me fjalë të tjera, është vendosur kontest administrativ. Me këtë rast do të theksonim ndryshimin midis termave procedurë administrative dhe kontest administrativ.

Koncepti i procedurës administrative: është procedura sipas të cilës ministrinë, organet e administratës shtetërore, organizatat e krijuara me ligj, organet e tjera shtetërore, personat juridikë dhe fizikë të cilëve u është besuar me ligj ushtrimi i kompetencave publike, si dhe organet e komunës, qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, detyrohen të veprojnë kur në ushtrimin e përgjegjësive të tyre veprojnë (të gjitha këto organe mbulohen me termin e përgjithshëm 'organet publike'), vendosin dhe ndërmarrin veprime të tjera administrative në çështje administrative.³⁶

Kontest administrativ: Mosmarrëveshje e cila zhvillohet dhe vendoset në një procedurë të posaçme administrative-gjyqësore pranë gjykatave të posaçme administrative, e cila vendos për ligjshmërinë e akteve administrative (mund të mbajnë titullin "vendim, leje, licencë", etj.) kur me to është vendosur për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë.³⁷ Kontesti administrativ në vendin tonë zhvillohet në Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e lartë administrative.

- Kontesti administrativ në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullohet për të përmbushur të gjitha standardet e përcaktuara në dokumentet e Këshillit të Evropës. Konkretisht, në kontestin administrativ:
- Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative themelohen me ligj dhe janë të pavarura;
- në përputhje me Ligjin për konteste administrative, objekt i kontrollit administrativ-gjyqësor, gjegjesisht i kontestit administrativ janë të gjitha aktet dhe veprimet administrative individuale të organeve publike (neni 2), dhe për të plotësuar këtë klauzolë të përgjithshme, neni 3 specifikon në detaje në cilat raste gjykatat do të vendosin në një kontest administrativ;
- Ligji për kontestet administrative parasheh në mënyrë eksplicite se një mosmarrëveshje administrative nuk mund të zhvillohet vetëm kur mbrojtja gjyqësore ofrohet jashtë një kontesti administrativ, si dhe në dy raste të tjera;
- procedura është kontradiktore;
- në kontekstin e vendimit brenda një afati të arsyeshëm, parashikohet parimi i efikasitetit, i cili pasqyrohet në mënyrë konkrete në detyrimin për të përfunduar mosmarrëveshjen administrative brenda nëntë muajve nga data e paraqitjes së të dhënave ose krijimi i kushteve për të vendosur në bazë të padisë;
- ekziston parimi i argumentit gojor, sipas të cilit gjykata merr një vendim, si rregull, në bazë të gjykimit publik, të drejtpërdrejtë dhe gojor;
- si rregull, në një kontest administrativ duhet të vendoset në juridiksion të plotë (në gjykim të zëvendësohet plotësisht akti specifik administrativ i cili kundërshtohet), dhe të mos anulohen aktet administrative dhe të rikthehen lëndët për vendim të serishëm³⁸ dhe
- tjetër.

35 Kontestet administrative rregullohen nga Ligji për konteste administrative, botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 96/2019, i cili filloi të zbatohet nga maji 2020.

36 Përkufizimi rrjedh nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, Gazeta Zyrtare nr. 124/2015.

37 Përkufizimi është nxjerrë nga Davitkovski B. Pavlovska-Daneva, A. (2020). Административно право – книга втора (процесно право), Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, Скопје, gjendet në: https://www.ukim.edu.mk/e-izdaniya/PRF/Administrativno_pravo_II.pdf (vizita e fundit më 31.5.2023), f.

38 Pra, me Ligjin për konteste administrative praktikisht shkohet një hap më tej se standardet minimale që kemi përshkruar më parë, të cilat janë përshkruar në Rekomandimin CM/Rec(2004)20, ku parashihej se tribunalet që kryejnë kontrollin gjyqësor duhet të jenë në gjendje të paktën t'i anulojnë aktet e administratës. Sipas Ligjit maqedonas për kontestet administrative, Gjykata Administrative duhet, si rregull, të vendosë pas padive në juridiksion të plotë, që do të thotë se nuk do t'ia kthejë çështjen për vendim të serishëm organit publik (ministrisë, organit përbërës, fondit, etj.), por me aktgjykimin e tij tërësisht do ta zëvendësojë aktin.

Por, për të përmbushur parimin e mbrojtjes ligjore, nuk mjafton vetëm të përshkruhet e drejta e kontrollit administrativ-gjyqësor mbi akte të veçanta administrative dhe/ose veprime të tjera administrative, por është gjithashtu e nevojshme të përmbushen standarde të caktuara në veprimin e Gjykatës administrative dhe Gjykatës së lartë administrative. Kështu, për shembull, rreziku që GJEDNJ të konstatojë se e drejta për gjykim brenda një kohe të arsyeshme është shkelur³⁹ do të ishte më i vogël nëse Gjykata administrative do të vendoste më shpesh në një juridiksion të plotë, në vend që thjesht të jepte vendime që anulojnë aktet administrative të sfiduara nga paditë dhe t'i kthejë çështjet në një rigjykim (veçanërisht pasi GJEDNJ, kur analizon gjykimin brenda një kohe të arsyeshme, do të merrte parasysh kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave para gjykatave maqedonase). Shpjegimi është i thjeshtë. Kur Gjykata administrative, me vendimin e saj, shfuqizon një akt administrativ specifik dhe rikthen çështjen për rishqyrtim, autoriteti publik rifillon nga fillimi procedurën administrative dhe sjell një akt të ri administrativ specifik, i cili, pavarësisht se Gjykata administrative jep udhëzime, mund të jetë përsëri i paligjshëm. Kundër këtij akti administrativ specifik, pala mund të paraqesë përsëri një padi, pas së cilës Gjykata administrative do të vendosë përsëri. Kështu, procedura vonohet dhe ekziston rreziku i shkeljes së standardit të arsyeshëm kohor (siç është rasti, në fakt, me një numër të madh të rasteve të paraqitura para GJEDNJ-së kundër RMV).

Nga ana tjetër, analizat tregojnë se Gjykata administrative nuk vepron në juridiksion të plotë, megjithëse Ligji për konteste administrative e parasheh këtë si rregull. Sipas një studimi, në 87 raste të analizuara në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të mbrojtjes sociale në periudhën nga 1 qershor 2020 deri më 1 dhjetor 2021, Gjykata administrative nuk ka marrë asnjë vendim të vetëm në juridiksion të plotë. Kjo do të thotë se dispozita e Ligjit për konteste administrative sipas të cilit vendosja në juridiksion të plotë është rregull, mbetet vetëm një fjalë në letër, pa zbatim praktik. Konkretisht, Gjykata administrative vazhdon t'i anulojë aktet administrative specifike të autoriteteve publike dhe kthen çështjet për rivendosje. Arsyeet pse Gjykata administrative vazhdon të dështojë në juridiksionin e plotë janë të paqarta. Dihet nga praktika se arsyeja më e zakonshme për miratimin e një aktgjykimi me të cilën anulohet vetëm akti administrativ konkret është mungesa e procesverbaleve nga autoriteti publik që ka miratuar aktin administrativ konkret, në mënyrë që Gjykata Administrative të mos jetë në gjendje të vendosë në juridiksion të plotë (për shembull, nëse Gjykata Administrative duhet të japë një të drejtë më të lartë për ndihmë monetare me aktgjykimin e saj, ajo duhet të marrë procesverbalet nga autoriteti publik kompetent për të parë se si është përcaktuar shuma e ndihmës monetare të dhënë). Megjithatë, kjo arsye nuk duhet të jetë problematike, duke marrë parasysh se Ligji për konteste administrative mundëson Gjykatën Administrative (si dhe Gjykatën e Lartë Administrative në rast se përballet me një problem të tillë) të vendosë një gjobë në masën 20% të pagës mujore të personit që ka miratuar aktin e kontestuar, domethënë ka ndërmarrë veprimin e kontestuar ose personit përgjegjës, gjegjësisht të autorizuar në organin publik që nuk i paraqet procesverbalet.

Përveç kësaj, Gjykata administrative duhet të njohë praktikën e GJEDNJ-së gjatë marrjes së vendimeve në konteste. Për shembull, sipas praktikës së GJEDNJ-së, gjykatat kombëtare (p.sh. Gjykata Administrative) duhet t'i interpretojnë rregullat procedurale pa formalizëm të tepruar, që do t'i linte palët pa të drejtën e qasjes në gjykatë.

39 Shumica e rasteve që kanë të bëjnë me të drejtat e mbrojtjes sociale kundër RMV janë raste kur është konstatuar se e drejta për gjykim është shkelur brenda një kohe të arsyeshme: Docevski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut; Ilievski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut; Kozarov kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, ne nuk do t'i kushtojmë shumë vëmendje këtyre rasteve sepse qëllimi i këtij Manuali është të përqendrohet më shumë në procedurat administrative, dhe jo aq shumë në kontestet administrative, në të cilat mjafton një përshkrim narrativ i së drejtës për gjykim të drejtë.

PARIMI I MBROJTJES JURIDIKE

<ul style="list-style-type: none">✓ kundër çdo akti administrativ apo kundër çdo veprimi administrativ, duhet të ketë një mundësi për mbrojtje gjyqësore në një kontest administrativ✓ mbrojtja gjyqësore në një kontest administrativ ofrohet edhe për të gjitha aktet individuale që mund të mos jenë të natyrës administrative, por për to nuk ka mbrojtje tjetër gjyqësore.✓ Gjykata Administrative vendos në juridiksion të plotë, me qëllim eliminimin e mundësive të shkeljes së detyrimit për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.	<ul style="list-style-type: none">✗ rregullat procedurale (për pranueshme rinë e padisë, përmbajtjen dhe formën e padisë, afatet, legjitimitimin aktiv⁴⁰ etj.) të ligjeve të cilat rregullojnë kontestin administrativ⁴¹ nuk interpretohen shumë ngushtë, me formalizëm të tepruar, për të pamundësuar qasjen në gjykatë
---	--

7. STANDARDE DHE PARIME TË TJERA

Në nivel të Këshillit të Evropës, por edhe në përputhje me legjislacionin maqedonas (Ligji për procedurën e përgjithshme administrative), ekzistojnë parime ose standarde të tjera në lidhje me procedurat administrative. Sipas Udhëzuesit: "Administrata dhe ti",⁴² u referohet disa parimeve, të cilat janë formuluar si më poshtë:⁴³

- **qasje:** Autoritetet publike do t'u përgjigjen kërkesave për akte administrative të cilat i kanë marrë nga individë që kanë të bëjnë me çështje brenda kompetencave të tyre ose në lidhje me të cilat individët kanë një interes të ligjshëm, duke përfshirë mundësinë për të filluar procedura administrative;
- **pjesëmarrje:** Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e vendimeve administrative të autoriteteve publike që prekin të drejtat dhe interesat e tij/saj;
- **e drejta për t'u dëgjuar:** Përpara se autoriteti publik të marrë vendimin administrativ që të ndikojë të drejtat dhe interesat e individit, personit në fjalë do t'i jepet mundësia të shprehë pikëpamjet e tij dhe t'i paraqesë informacion dhe argumente autoritetit publik;
- **përfaqësim dhe ndihmë:** Nëse autoriteti publik synon të refuzojë kërkesën e individit ose konsideron se një kërkesë e tillë ka të ngjarë të refuzohet, tërësisht ose pjesërisht, do t'i mundësojë individit të përfaqësohet ose të ndihmohet në një mënyrë ndryshe në shprehjen e pikëpamjeve të tij, sidomos kur vendimi administrativ mund të ndikojë drejtpërdrejt dhe negativisht në të drejtat ose interesat e tij ose të saj;
- **kufizime kohore:** Procedurat administrative që do të çojnë në një akt që do të ndikojë në të drejtat dhe interesat e individit do të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm;
- **forma dhe njoftimi për vendimet administrative:** Vendimet administrative do të përgatiten në një gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshme. Ato do të përfshijnë arsyet e vendimit, përkatësisht bazën përkatëse ligjore dhe faktike mbi të cilën vendimi është ashtu siç është. Kur akti do të ndikojë negativisht në të drejtat dhe interesat e individit, do të ketë informacion mbi mjetet juridike në dispozicion dhe procedurat e apelit, si dhe informacion mbi afatet. Individët do të njoftohen

40 Legjitimitimi aktiv do të thotë që paditësi ka një marrëdhënie të veçantë me aktin/vendimin administrativ të cilën e konteston para gjykatave administrative, pra që akti administrativ i kontestuar cenon të drejtën ose interesin e tij ligjor. Ekzistenca e legjitimitimit aktiv është e thjeshtë për t'u përcaktuar kur akti është miratuar dhe në të është përcaktuar me emër personi që paraqitet si paditës. Por në disa raste, mund të lindë pyetja nëse ekziston një legjitimitet aktiv. Për shembull, a mund të paraqitet fqinji i personit që i është dhënë leja për të ndërtuar një ndërtesë të lartë si paditës kundër një miratimi të tillë, marrë parasysht se atij do t'i cenohet gëzimi i hapësirës së tij? Në raste të tilla, kuptimi i termit "person i interesuar" në nenin 4, paragrafi 1, rreshti 2 i Ligjit për konteste administrative duhet të interpretohet gjerësisht.

41 Te ne, siç u përmend, ky është Ligji për konteste administrative nga viti 2019.

42 Shih f. 27 deri 40 nga "Udhëzues: Administrata dhe ti" gjendet në <https://book.coe.int/en/international-law/7713-the-administration-and-you-a-handbook.html> (vizita e fundit më 31.05.2023), f.

43 Përkthimi i parimeve nga "Udhëzues: Administrata dhe ti" është bërë nga autori, nga anglishtja në maqedonisht.

personalisht për vendimin. Vetëm përjashtimisht, ose nëse vendimi prek një numër të madh personash, mund të përdoret mënyra e shpalljes publike;

- **ekzekutimi i vendimeve administrative:** Vendimet administrative që prekin të drejtat dhe interesat e individëve do të kryhen brenda një kohe të arsyeshme, duke marrë parasysh të gjitha interesat përkatës.

Sa i përket parimit të parë të qasjes, në vendin tonë ai parashihet në disa nene të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, gjegjësisht prej tij buron se autoritetet publike duhet t'i përgjigjen gjithmonë një kërkesë të paraqitur nga një palë, ndërsa në të kundërt në një procedurë administrative ndodh e ashtuquajtura "heshtje e administratës" (për të cilën kemi folur më parë). Rreth këtij parimi, një rast interesant është deklaruar në botimin "Udhëzues: Administrata dhe ti". Gjegjësisht, në lëndën *Markov dhe Markova v. Ukraine* KEDNJ vuri në dukje se kishte një konfuzion në nenin 12 të KEDNJ. Në rastin në fjalë, znj. Markova ishte ankuar se autoritetet publike nuk e lejonin atë të martohet me z. Markov sepse atij nuk i jepej një certifikatë se është i divorcuar nga martesja e mëparshme. Certifikata nuk i është dhënë sepse ka qenë në burg dhe nuk ka mundur të paraqitet në ambientet e autoritetit publik për ta marrë certifikatën. Pra, është e nevojshme të shmanget interpretimi kufizues i rregulloreve kur ato parashohin prani personale në një autoritet publik konkret, gjë që është diçka e zakonshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

E drejta për të marrë pjesë dhe e drejta për t'u dëgjuar janë gjithashtu të përfaqësuara në mënyrë adekuate, duke pasur parasysh se ekziston një parim i dëgjimit të palëve (neni 11) sipas të cilit para nxjerrjes së aktit administrativ, palës duhet t'i jepet mundësia për të deklaruar faktet dhe rrethanat përkatëse për vendimin (përjashtimet mund të parashikohen vetëm në ligje të veçanta).

Lidhur me afatet, formën dhe njoftimin e aktit administrativ, dispozitat e detajuara janë të përcaktuara në Ligjin maqedonas për procedurë të përgjithshme administrative. Së pari, sa i përket afatit, procedurat administrative në shkallën e parë parashohin me saktësi se për sa kohë përfundon procedura (neni 93), dhe së dyti, në lidhje me formën dhe raportimin, dispozitat e hollësishme përmbahen në nenet 87 dhe 88 (për formën) si dhe në kapitullin XV (për njoftimin).

Duke folur për parimet dhe standardet që janë të rëndësishme në procedurat administrative, dy parime janë paraparë në të drejtën e procedurës administrative dhe këto janë parimi i **ndihmës aktive të palës** dhe **parimi i orientimit servisor të palës** (neni 17 dhe neni 9 i Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative).

Sipas parimit të ndihmës aktive të palës, organi publik, jo vetëm që është i detyruar t'u mundësojë të gjitha palëve në procedurë t'i realizojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre dhe interesat juridike në mënyrën më efektive dhe më të lehtë të mundshme, por *ai edhe i njofton palët për dispozitat ligjore që janë me rëndësi për zgjidhjen e punës administrative, për të drejtat dhe obligimet e tyre, përfshirë edhe për të gjitha informatat e tjera relevante*. Gjithashtu është paraparë në mënyrë eksplicite se pala ka qasje në autoritetin publik në mënyrë elektronike dhe se mosdija ose neglizhenca e palës nuk do të jetë në dëm të saj. Ky parim është veçanërisht i rëndësishëm në procedurën administrative. Kjo do të thotë që nëpunësit jo vetëm që nuk duhet t'i pengojnë palët të ushtrojnë të drejtat e tyre, por duhet t'i ndihmojnë dhe t'i mësojnë drejtpërdrejt për të drejtat dhe interesat e tyre. Këtu bëjmë ndërlidhje edhe me parimin e orientimit servisor. Gjegjësisht, zbatimi korrekt i këtyre dy parimeve do të nënkuptonte, në praktikë, një qëndrim proaktiv të nëpunësve në ndihmë të individëve. Në një shembull hipotetik, nëse "një person i caktuar ka aplikuar për ushtrimin e së drejtës për ndihmë monetare të njehershme, dhe ai plotëson kushtet për ushtrimin e së drejtës për ndihmë monetare të përhershme, nëpunësi i Qendrës për punë sociale është i detyruar, në përputhje me këtë parim, të informojë personin për këtë mundësi ligjore, pa pritur që ai ta kërkojë këtë."⁴⁴

44 Хаџи Зафиров Ж, Ѓеоргиевски Ј. (2017). Практични прашања & одговори за примена на Законот за општата управна постапка, Министерство за информатичко општество и администрација, Шкуп, gjendet në: https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/Primena-na-noviot-zakon-ZUOP_03.pdf (vizita e fundit më 31.5.2023), f. 17.

III.

STANDARDE QË U REFEROHEN FUSHAVE TË VEÇANTA (TË DREJTAT SOCIALE)⁴⁵

1. PRAKTIKA E GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT PËR TË DREJTAT E SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR

Të drejtat për sigurim pensional dhe invalidor nuk identifikohen në KEDNJ si të drejta që mbrohen në mënyrë eksplicite. Megjithatë, në praktikën e saj, GJEDNJ ka filluar të shqyrtojë rastet që lidhen me të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor përmes prizmit të të drejtave të tjera, domethënë përmes garancive nga KEDNJ dhe protokollet, dhe më shpesh për:

- të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, sipas nenit 6 të KEDNJ;
- ndalimin e diskriminimit sipas nenit 14 të KEDNJ;
- mbrojtjen e pronës, sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ.

Me fjalë të tjera, GJEDNJ nuk ndërhyr në një vlerësim të mënyrës së rregullimit të sigurimit pensional dhe invalidor në rendin ligjor të vendit (për shembull, sa vite moshe ose përvojë pune kërkohen për një pension pleqërie, cilat janë kushtet për marrjen e një pensioni invalidor, mënyra e përcaktimit të shumës së pensionit, kundrejt shumës së fondeve/kontributeve të paguara për sigurimin pensional dhe invalidor e të ngjashme). Megjithatë, GJEDNJ vlerëson nëse ka pasur shkelje të ndonjë prej neneve të GJEDNJ dhe protokolleve të saj në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor.

Kështu, në lidhje me nenin 6, GJEDNJ shqyrton nëse, në çështjet që kanë të bëjnë me pensionet (të drejtat e sigurimit pensional ose invalidor), është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 6 të GJEDNJ-së. Një shembull në këtë konotacion është rasti *Zednik v. the Czech Republic*, ku autoritetet çeke të sigurimit social privuan aplikantin nga kompensimi për invaliditetin të pjesshëm, ndërsa Gjykata Kushtetuese, e cila ka vendos në shkallën e fundit, nuk ka bërë asnjë lloj shqyrtimi të rastit, sepse e ka konsideruar atë jashtë afateve ligjore. GJEDNJ ka konstatuar shkelje të së drejtës së qasjes në gjykatë, gjegjësisht ka konstatuar se edhe Gjykata Kushtetuese ka insistuar tepër në formalitetet procedurale dhe në këtë mënyrë nuk është futur në shqyrtimin e bazueshmërisë së rastit, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën për mbrojtje efektive.

Nga ana tjetër, në nenin 14, GJEDNJ shqyrton nëse në rastet e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor ka shkelje të ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit. Kjo gjë në vetvete, është logjike, duke pasur parasysh se neni 14 nuk ka kuptim të pavarur, por duhet të lidhet me ndonjë të drejtë tjetër, kështu që për GJEDNJ është e rëndësishme nëse autoritetet shtetërore bëjnë diskriminim të paligjshëm midis qytetarëve, gjegjësisht nëse legjislacioni shtetëror çon në diskriminim midis qytetarëve që duan të ushtrorjnë të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor. Si shembull mund të citojmë rastin *Wessels-Bergervoet v. Holandë*, dhe gjithashtu rastin e cituar më parë *Kjartan Ásmundsson v. Iceland*.

Së fundi, një e drejtë veçanërisht e rëndësishme që buron nga Protokollin 1, neni 1 i KEDNJ, është e drejta për mbrojtjen e pronës dhe për të gëzuar pronën: Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën të gëzojë qetësisht pronën e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik

45 Çështjet që lidhen me këto të drejta janë marrë nga: Guide on the case-law of the European Convention on Human Rights – Social Rights, European Court of Human Rights, 2022., gjendet në: https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Social_rights_ENG.pdf (vizita e fundit më 31.5.2023); Social security as a human right - The protection afforded by the European Convention on Human Rights, Council of Europe 2007, gjendet në: [https://www.echr.coe.int/LibraryDocs/DG2/HRFILES/DG2-EN-HRFILES-23\(2007\).pdf](https://www.echr.coe.int/LibraryDocs/DG2/HRFILES/DG2-EN-HRFILES-23(2007).pdf) (vizita e fundit më 31.5.2023).

dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. e... Dispozitat e mëparshme nuk cenon të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera. (paragrafët 1 dhe 2). GJEDNJ e trajton të drejtën e pensionit si "posedim" ose "pronë", që nënkupton se, edhe pse e drejta për pension nuk garantohej nga KEDNJ, në rrethana të caktuara mund të barazohet me ligjin e pronës. Ka disa raste në të cilat GJEDNJ ka vendosur për të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor, duke interpretuar nenin 1 të Protokollit 1: *Koufaki and Adedy v. Greece*, *Da Conceição Mateus and Santos Januário v. Portugalia* dhe *Da Silva Carvalho Rico v. Portugal*, i përmenduri më parë *Kjartan v. Ásmundsson Iceland* dhe kështu me radhë.

Nga çështjet e shumta lindin disa standarde që janë të rëndësishme për procedurat administrative në të cilat vendosen të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor.

2. PRAKTIKA E GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT PËR TË DREJTAT E MBROJTJES SOCIALE

Ashtu si me të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor, të drejtat e mbrojtjes sociale, si të tilla, nuk mbrohen drejtpërdrejt nga KEDNJ. Megjithatë, GJEDNJ vepron në rastet në të cilat vërtetohet se ka pasur shkelje të ndonjë neni tjetër të KEDNJ ose të protokolleve në procedurë kur është vendosur për të drejtat e mbrojtjes sociale, në veçanti sipas nenit 6 (*Mennitto v. Itali*, *Salesi v. Itali*, *Kovaçev v. Bullgaria*), Neni 1 i Protokollit 1 (*Stummer v. Austria*, *Efe v. Austria*, *Čakarević v. Kroacia*), por neneve 2 dhe 3 të KEDNJ (*La Parola and others v. Itali*, *Larioshina v. Russia*).

3. STANDARDET NË LIDHJE ME TË DREJTAT E SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR DHE TË DREJTAT E MBROJTJES SOCIALE

Nga rastet e renditura më sipër, si dhe rastet e tjera të praktikës së GJEDNJ, dalin disa standarde që janë relevante për autoritetet publike që zhvillojnë procedura dhe vendosin për të drejtat e mbrojtjes sociale dhe të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor.

3.1. Proporcionaliteti

Një nga këto parime është proporcionaliteti, i cili buron prej shumë rasteve. Rasti *Romeva kundër Maqedonisë* i referohet një pensioni që dikur u miratua në vitin 2000, dhe më pas vendimi për pension u revokua në vitin 2007 (sepse u bë si rezultat i një gabimi të Fondit i sigurimit pensional dhe invalidor), kështu që aplikantja humbi plotësisht të drejtën për të marrë një pension, dhe madje u ngrit një padi civile kundër saj dhe u iniciua një procedurë përmbarimore duke i kërkuar asaj të kthejë shumën e marrë. GJEDNJ vërtetoi shkelje të nenit 1 të Protokollit 1, në lidhje me parimin e proporcionalitetit. Gjegjësisht, aplikantja u vendos në një pozitë me barrë të tepërt individuale, në kundërshtim me interesin publik që mbrohej në situatën në fjalë.

Një shembull tjetër i parimit të proporcionalitetit, kur bëhet fjalë për pensionet, do të ishte *Lakićević and Others v. Montenegro and Serbia*. Katër aplikantët, avokatë, shtetas malazezë, kanë fituar të drejtën e pensionit, por kanë vazhduar të punojnë me kohë të pjesshme midis 1996 dhe 2002, gjë që lejohej sipas ligjit në fuqi në atë kohë. Në vitin 2003, hyri në fuqi një Ligj i ri për sigurim pensional dhe invalidor, sipas të cilit Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor pezulloi pensionet e katër aplikantëve derisa ata nuk do të pushonin së punuari me kohë të pjesshme. Parashtruesit i shteruan mjetet juridike në dispozicion para ministrisë kompetente dhe gjykatave shtetërore, gjë pas kësaj paraqitën një ankesë në GJEDNJ, e cila konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 1, Protokollit 1, domethënë se aplikantëve u ishte shkelur në mënyrë disproporcionale e drejta për të gëzuar qetësisht pronën. Gjegjësisht, GJEDNJ vuri në dukje se, në përputhje me rregullat e pensioneve në fuqi në atë kohë dhe të inkurajuara nga sistemi i pensioneve

në të cilin ata kishin kontribuar për disa vite, ata kanë rihapur zyrat e tyre private me kohë të pjesshme, duke vazhduar të marrin një pension të plotë. Vendimi për pezullimin e pensioneve nuk është për shkak të ndonjë ndryshimi në rrethanat e aplikantëve, por për shkak të ndryshimeve në ligj. Ai veçanërisht i ka goditur aplikantët, pasi e ka pezulluar plotësisht pagesën e pensioneve që kishin marrë për disa vite, që do të duhej të përbënin një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të tyre mujore bruto. Për më tepër, aplikanti i parë, i dytë dhe i tretë ishin gjithashtu të detyruar të shlyenin shumat që kishin marrë pas 1 janarit 2004. Kështu, aplikantët u detyruan të mbanin një barrë të tepruar dhe joproporcionale, e cila, edhe duke marrë parasysh marzhën e gjerë të vlerësimit që gëzonte shteti në fushën e legjislacionit social, nuk mund të justifikohet nga interesi i ligjshëm publik mbi të cilin mbështetej qeveria malazeze. Situata mund të kishte qenë ndryshe nëse aplikantët do të kishin qenë të detyruar të marrin një reduktim të arsyeshëm dhe proporcional në vend të një pezullimi të plotë të të drejtave të tyre, ose nëse ligjvënësi do t'u kishte dhënë atyre një periudhë kalimtare brenda së cilës do të mund të përshtateshin me skemën e re.

Pra, siç kemi theksuar më parë, një nga parimet më të rëndësishme për të gjitha procedurat administrative në përgjithësi, si dhe për procedurat e të drejtave sociale, është parimi i proporcionalitetit. Sa herë që detyrimet i imponohen një individ (të tilla si, për shembull, shlyerja e një shume të një pensioni që është paguar gjatë një numri vitesh për shkak të një vendimi të gabuar të një fondi pensional), duhet të tregohet kujdes për të balancuar interesin e individit me interesin publik që mbrohet.

3.2. Duke marrë parasysh 'qëllimin e mirë' (good faith)

Ndryshe nga standardi i proporcionalitetit, i cili është tipik për të gjitha procedurat administrative, standardi për të marrë parasysh qëllimin e mirë të aplikantit është specifik për këtë lloj rasti/procedure.

Këtë standard mund të shohim në një numër të madh rastesh dhe pikërisht një prej tyre është *Romeva kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*.

Për çfarë bëhet fjalë?

Sipas GJEDNJ, kur autoritetet publike rishikojnë vendimet e tyre të gabuara, është e ligjshme për ta që t'i shfuqizojnë/anulojnë/ndryshojnë ato me qëllim që të mbrojnë interesin publik. Por përveç marrjes parasysh të proporcionalitetit, autoritetet publike duhet të marrin parasysh edhe këtë: Në procedurën fillestare, kur është nxjerrë akti administrativ që më vonë është konstatuar i gabuar, a ka pasur aplikanti qëllime të mira?

Të përkujtojmë.

Domethënë, Romeva ka aplikuar dhe ka marrë pension në vitin 2000, dhe në vitin 2007 është vërtetuar se akti fillestar administrativ që i ka mundur asaj pensionin ishte i gabuar, gjë për të cilën, me një vendim të ri të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor i është revokuar e drejta e saj për pension, dhe madje është iniciuar edhe një procedurë civile kundër saj për të kthyer shumat e marra nga 2000 në 2007. Një rrethanë që GJEDNJ konsideroi në këtë rast është se Romeva, në vitin 2000, ka paraqitur kërkesën për pension me qëllim të mirë, domethënë, nga faktet në këtë rast, nuk mund të konkludohet se Romeva "ka ndërmarrë veprime me qëllim të mashtrimit të Fondit ose se ka vepruar në ndonjë mënyrë tjetër me qëllim të keq kur ka paraqitur kërkesën për pension apo në çfarëdo kohe tjetër gjatë komunikimit të saj me Fondin...".⁴⁶ Edhe komisioni i shkallës së dytë, i cili vendos për ankesat, konstatoi se ndaj kërkesës janë bashkëngjitur të dhëna të gabuara, por nuk ka pasur asnjë përgjegjësi të aplikantes për sigurimin e të dhënave të tilla.⁴⁷

Kur kërkesa drejtuar autoriteteve publike që kanë vendosur në procedurë administrative paraqitet me qëllim të mirë, ajo duhet të merret parasysh në procedurë gjatë rishikimit të aktit administrativ të miratuar nga autoritetet publike, i cili është i gabuar dhe i imponon detyrime individit.

46 Romeva kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjendet në: <https://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2020/02/Prevod-ROMEVA-v.-RSM.pdf> (vizita e fundit më 15.06.2023), f. 9, paragrafi 43.

47 Ibid.

I ngjashëm është artikulli *Čakarević v. Croatia*. Čakarević,⁴⁸ një shtetase kroate, rezultoi e papunë në vitin 1995 dhe mori sigurimin e papunësisë (përfitimet në rastin e papunësisë) nga Byroja kroate e punësimit. Sipas ligjit aktual, këto përfitime mund të merren për një kohëzgjatje maksimale prej 12 muajsh. Por Byroja kroate e punësimit ia ka paguar ato deri në mars 2001. Čakarević më pas ishte informuar nga Byroja e punësimit se e drejta e saj për përfitime kishte pushuar në vitin 1998 dhe se ajo duhej të shlyente fondet e paguara nga 1998 në 2001 (afërsisht 2,600 euro, plus interes). Mes tjerash, në aktgjykimin e saj, GJEDNJ konstaton se nuk është e kontestueshme se Čakarević kishte vepruar me qëllim të mirë, domethënë se nuk ka pasur ndërmend të mashtrojë Byronë e punësimit dhe gjëra të ngjashme. Kjo është dashur të merret parasysh para se t'i kërkohej t'i kthente fondet. Së fundi, GJEDNJ evidentoi një shkelje të nenit 1, Protokollin 1 i GJEDNJ. Qëllimi i mirë u mor parasysh si një element shtesë, ku u vlerësua se Čakarević kishte pasur pritshmëri legjitime se fondet që ajo kishte marrë i përkisnin asaj.

3.3. Mosvendosja e kushteve arbitrare

Ky standard buron nga *Klein v. Austria*. Aplikanti ka qenë avokat, por ka falimentuar dhe ka humbur atë status me vendim të vetë Odës së Avokatëve, duke humbur kështu statusin e anëtarit të Odës së Avokatëve. Ai ka kërkuar që të ushtrojë të drejtën e pensionit sepse kishte paguar kontribute për më shumë se 32 vjet, por ka marrë përgjigjen (e cila më vonë u konfirmua nga Gjykata Administrative) se një pension pleqërie merret vetëm nëse një individ është anëtar i Odës së Avokatëve deri në moshën 65 vjeç, ndërsa *Klein* kishte humbur anëtarësimin e tij para kësaj. Sipas GJEDNJ-së, rregullat nuk duhet të interpretohen në mënyrë kaq të ngurtë duke vendosur një kusht arbitrar për moshën, gjegjësisht që në këtë rast aplikantit nuk është dashur t'i hiqet plotësisht e drejta për pension, edhe pse ai ka paguar kontribute mbi 32 vjet. Gjithashtu, GJEDNJ konstaton shkelje të parimit të proporcionalitetit.

3.4. Mosdiskriminimi

Në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat sociale, GJEDNJ përcakton se një nga standardet, si në çdo procedurë tjetër, është barazia, domethënë mungesa e diskriminimit. Duke qenë se kësaj ngjarjeje më parë i është kushtuar më shumë vëmendje, në këtë rast nuk do ta shtjellojmë në mënyrë të veçantë.

4. RISHIKIMI I DISA RASTEVE NË FUSHËN E TË DREJTAVE SOCIALE KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në përgjithësi, në rastet kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut që kanë të bëjnë me të drejtat sociale (të drejtat për sigurim pensional dhe invalidor dhe mbrojtje sociale), janë evidentuar shkelje të nenëve 6 dhe 1 të Protokollit 1 të Konventës. Këto shkelje kanë të bëjnë me të drejtat e sigurimit pensional, gjegjësisht me llogaritjen e pensionit, ushtrimin e të drejtës për pension invalidor e gjëra të ngjashme. Mund të vihet re se para Gjykatës Evropiane nuk është ngritur asnjë çështje në lidhje me mbrojtjen sociale (me përjashtim të çështjes për shtesën prindërore dhe rimbursimin e kostove për trajtim jashtë vendit), prandaj lind pyetja nëse këto palë, të cilat kryesisht i përkasin grupeve të marginalizuara të qytetarëve, janë në dijeni të mundësisë për paraqitje së aplikimit, veçanërisht nëse bëhet fjalë për realizimin e ndihmës sociale, tarifave ose shtesave që për ta mund të përbëjnë një burim të vetëm të të ardhurave. Përveç kësaj, shtrohet pyetja nëse këto kategori qytetarësh mund të përballojnë një avokat nga pikëpamja financiare për të paraqitur ankesë në GJEDNJ.

Në lidhje me shkeljen e nenit 6 të Konventës, Gjykata, në shumicën e çështjeve, ka konstatuar shkelje të nenit 6, i cili i referohet kohëzgjatjes së procedurës, gjegjësisht shkeljes së parimit të gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Konkretisht, Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në përputhje me rrethanat e çështjes, me theks të veçantë në kriteret e mëposhtme: kompleksiteti i çështjes, sjellja e aplikantit dhe e autoriteteve përkatëse dhe cili ka qenë roli i aplikantit

48 Rasti është përmbledhur dhe shpjeguar në linkun e mëposhtëm: <https://www.hrlc.org.au/human-rights-case-summaries/2018/8/13/unemployment-benefits-mistakenly-paid-by-croatian-government-do-no-have-to-be-repaid-european-court-of-human-rights-finds> (vizita e fundit më 15.06.2023).

në kontest. Kështu, në çështjet që prekin shtetin tonë, Gjykata ka konstatuar se procedurat kanë zgjatur shumë dhe janë vonuar, megjithëse nuk është bërë fjalë për çështje komplekse. Përveç kësaj, zvarritja ka qenë rezultat i kthimit të çështjes për veprim të serishëm, madje edhe disa herë me radhë. Sipas Gjykatës, përsëritja e procedurave tregon një të metë serioze në sistemin ligjor, sidomos që vonesa të tilla nuk mund t'u atribuohen palëve, por shtetit, dhe për këtë arsye kohëzgjatja e procedurave ka qenë e tepruar dhe nuk ka arritur të përmbushë kërkesat për një "gjykim brenda një kohe të arsyeshme".

Në çështjet që kanë të bëjnë me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, Gjykata ka vendosur që një shtet që ka legjislacion në fuqi i cili parasheh përfitime të sigurimit social ose pension - pavarësisht nëse ky përfitim është i kushtëzuar ose jo nga pagesa e kontributeve - duhet të konsiderohet si krijues i interesave të pronësisë që bien brenda kuadrit të nenit 1 të Protokollit 1. Kjo çon drejt faktit që të drejtat e pensionit mund të konsiderohen të drejta pronësore nëse plotësojnë kushte të caktuara. Kështu, Gjykata, në praktikën e saj gjyqësore, të cilën e ka zbatuar edhe në çështjet kundër shtetit tonë, ka konstatuar se neni 1 i Protokollit 1 përmban tre rregulla të veçanta: rregulli i parë shpreh parimin e gëzimit qetësisht të pronës; rregulli i dytë mbulon privimin e pronës dhe i nënshtrohet disa kushteve; dhe rregulli i tretë pranon se shteti ka të drejtë të kontrollojë përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Nga kjo rrjedh se këto parime janë po aq të rëndësishme kur bëhet fjalë për rastet e sigurimit social, asistencës sociale, të drejtave pensionale dhe të ngjashme.

Në rastet që prekin vendin tonë, Gjykata ka konstatuar se nuk është arritur një ekuilibër i drejtë midis kërkesave në interes të përgjithshëm të publikut dhe kërkesave për të mbrojtur të drejtat themelore të individit dhe se barra mbi aplikantët ka qenë shumë e madhe. Më pas, Gjykata ka shqyrtuar nëse ndërhyrja ka qenë e parashikuar me ligj dhe nëse ajo ka qenë e ligjshme. Kjo për shkak se Gjykata, në disa raste, ka konstatuar se përzierja nuk ka gjetur një ekuilibër të drejtë midis interesit të përgjithshëm të bashkësisë dhe të drejtave të individit. Gjykata, në raste të tilla, ka shqyrtuar faktet relevante duke përdorur "testin Fábían",⁴⁹ gjegjësisht, shumën e përfitimit të humbur, të drejtën e zgjedhjes dhe lartësinë e mjeteve të humbura me të cilën është ballafaquar aplikanti.

49 Fábían v. Hungary, aplikimi nr.78117/13, qasur nëpërmjet: <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22fulltext%22:%5B%22F%2F%20%20A1bi%20%20A1n%20v.%20Hungaria%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-176769%22%5D%7D> (vizita e fundit më 15.6.2023).

FRAGMENTE NGA RASTET MË TË RËNDËSISHME TË CITUARA

ÇËSHTJE PARA GJEDNJ NË LIDHJE ME MBROJTJEN SOCIALE ⁵⁰	
ÇËSHTJE KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	
ÇËSHTJA NR.1	
Çështja:	Romeva kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut (aplikimi nr. 32141/10)
Link:	https://shorturl.at/fsK02
E drejta dhe ligji i shkelur:	Shkelja e gëzimit paqësor të pronës dhe shkelja e standardit nëpërmjet parimit të proporcionalitetit
Përshkrim:	
<p>Aplikantja ishte e papunë dhe ka marrë kompensim monetar përmes sistemit të ndihmës sociale në rast të papunësisë. E drejta e saj për të vazhduar marrjen e një ndihme të tillë pushon në kohën kur ajo të punësohet ose të përmbushë kushtet për ushtrimin e së drejtës së saj për pension. Në vitin 2000, aplikantja ishte udhëzuar nga Agjencia e Punësimit që të aplikojë për pension në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor, i cili i miratoi asaj pensionin dhe zbuloi se, me një kohëzgjatje shërbimi prej 35 vjetësh, 10 muajsh dhe 24 ditësh, ajo plotësonte kushtin e të pasurit kohëzgjatje të mjaftueshme shërbimi për të ushtruar të drejtën e një pensioni, i cili ishte i vetmi kusht në atë kohë. Vendimi ka hyrë në fuqi dhe aplikantja kishte filluar të merrte pension.</p> <p>Në vitin 2007, Fondi kreu një kontroll të brendshëm të dokumentacionit të tij dhe zbuloi se të dhënat e disa përfituesve të pensioneve nuk ishin të plota dhe se në disa raste të dhënat në lidhje me punësimin e mëparshëm mungonin ose nuk ishin të plota. Sa i përket aplikantes, në raport deklarohet se, edhe pse të dhënat tregonin se ajo kishte qenë e punësuar për periudhën e kërkuar, kishte munguar librezja e saj e punës. Për këtë arsye, është vendosur të pyetet punëdhënësi ku ka punuar midis 1963 dhe 1967 për të konfirmuar këtë periudhë të punësimit të saj. Meqë nuk u sigurua asnjë provë, Fondi anuloi vendimin e vitit 2000 dhe hodhi poshtë kërkesën e ankueses për pension. Në vendimin e tij, Fondi deklaroi se informacioni që zotëronte në lidhje me punësimin e aplikantes nuk ishte i saktë për periudhën midis 1963 dhe 1967, që tregon se në atë kohë ajo nuk ka qenë e punësuar. Prandaj, ajo nuk e ka plotësuar kriterin e detyrueshëm për t'u kualifikuar për pension - më saktë, të ketë kohë shërbimi prej minimum tridhjetë e pesë vjetësh. Aplikantja ka ankimuar vendimin dhe ka pretenduar se neni 145-A i Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor është miratuar pas datës kur i është aprovuar shfrytëzimi i pensionit, kështu ai nuk ka mundur të zbatohet në mënyrë retroaktive në rastine saj.</p> <p>Aplikantja ka nisur procedurë para Gjykatës Administrative, e cila ka miratuar padinë dhe ka anuluar vendimin e Komisionit të shkallës së dytë. Gjykata Administrative ka konstatuar se neni 145-A i Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor ishte zbatuar në mënyrë retroaktive në rastin e aplikantes. Neni në fjalë ka hyrë në fuqi më 14 qershor 2006, prandaj nuk mund të zbatohet në vendimin e vitit 2000 që lidhet me aplikanten. Komisioni i shkallës së dytë kishte marrë një vendim të ri duke hedhur poshtë ankesën e aplikantes. Ajo përsëri ngriti padi në Gjykatën Administrative duke përsëritur se, në përputhje me ligjin vendas, Fondi ishte përgjegjës për saktësinë e të dhënave në lidhje me punësimin dhe detyrimi i punëdhënësit ishte të paraqiste dokumentet përkatëse. Përveç kësaj, kishte deklaruar se vendimi i vitit 2000 nuk i referohej periudhave specifike të punësimit, kështu që aplikantja nuk ka mundur të jetë e vetëdijshme për disa parregullsi të caktuara. Nisur nga kjo, çdo pretendim se ajo ka pranuar të dhëna të rreme me vetë paraqitjen e kërkesës për pension në Fond ose ndonjë tjetër përgjegjësi, është e pabazë. Gjykata Administrative e refuzoi padinë e saj, si dhe ankesën kundër këtij vendimi.</p>	

50 Për sqarim: në disa nga këto raste përmendet se Gjykata e Lartë ka vepruar në kontest administrativ, ndërsa në tekstin e mëparshëm thuhet se Gjykata Administrative (kontest administrativ në shkallën e parë) dhe Gjykata e Lartë Administrative (kontest administrativ në shkallën e dytë për ankesat kundër vendimeve të Gjykatës Administrative) janë ato të cilat veprojnë në një kontest administrativ). Por situata ishte ndryshe derisa u miratua Ligji i parë për konteste administrative (Gazeta zyrtare nr. 62/06 ... 171/10), me të cilën u formua Gjykata Administrative. Konkretisht, në periudhën para këtij Ligji për konteste administrative të vitit 2006, përgjegjëse për zgjidhjen e kontesteve administrative ishte gjykata e lartë.

Aplikantja paraqiti aplikim në GJEDNJ për shkelje të pretenduar të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, për heqje të së drejtës për pension, duke shkelur kështu parimin e sigurisë juridike. Në shqyrtimin e çështjes, Gjykata deklaroi se neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk kufizon lirinë e shteteve për të vendosur nëse do të kenë apo jo ndonjë formë të sigurimeve sociale ose sistemit të pensioneve, ose për të zgjedhur llojin dhe sasinë e përfitimeve të parashikuara nga sistemi i tillë. Megjithatë, kur shteti ka legjislacion në fuqi që parasheh përfitime të sigurimeve sociale ose pensioneve - pavarësisht nëse këto përfitime janë të kushtëzuara ose jo nga pagesa e kontributeve - ai legjislacion duhet të konsiderohet si krijues i interesave pronësore që bien në kuadër të nenit 1 të Protokollit nr. 1, por vetëm për personat të cilët plotësojnë kushtet. Në këtë rast të veçantë, lëshimi vjen nga autoritetet kompetente të cilat duhej të kishin kontrolluar nëse personi në fjalë i plotëson apo jo kushtet e nevojshme për marrjen e pensionit. Në fakt, një vlerësim i tillë është kryer dhe ankueses i është miratuar pensioni. Për më tepër, nga faktet e çështjes nuk mund të nxirret përfundimi se ajo ka vepruar me qëllim mashtrimin e Fondit, ose me qëllim të keq kur ka aplikuar për pension ose në çdo kohë gjatë komunikimit të saj me Fondin.

Parimet e përgjithshme që lidhen me shtrirjen e zbatimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 janë po aq relevante kur bëhet fjalë për raste të sigurimit social dhe ndihmës sociale. Në këtë rast, për Gjykatën si rregull i përgjithshëm, kushti i parë dhe më i rëndësishëm i nenit 1 të Protokollit nr. 1 është që çdo ndërhyrje e autoriteteve shtetërore në gëzimin paqësor të pasurisë duhet të jetë e ligjshme dhe proporcionale. Çdo ndërhyrje duhet të arrijë një "ekuilibër të drejtë" midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të bashkësisë dhe kërkesave për të mbrojtur të drejtat themelore të individit. Gjykata ka zbuluar se privimi i aplikantes nga pensioni i saj kishte një qëllim legjitim – domethënë të siguronte që fondet publike nuk kishin për qëllim të subvenciononin përfituesit e pamërituar për një kohë të pacaktuar. Megjithatë, Gjykata ka konstatuar se nuk është arritur një ekuilibër i drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të publikut dhe kërkesave për të mbrojtur të drejtat themelore të individit dhe se barra mbi aplikanten ka qenë shumë e madhe. Kjo për shkak se Gjykata ka konstatuar se çështja në fjalë nuk kishte të bënte me ndërprerjen e pensionit të aplikantes, por me humbjen totale të të drejtave të saj pensionale. Përveç kësaj, padia civile kundër aplikantes dhe procedura përmbartimore, me qëllim kërkimin e rimbursimit të pensioneve të paguara, rëndojnë më tej gjendjen e saj financiare tashmë të vështirë. Për këto arsye, Gjykata ka konstatuar se bëhet fjalë për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

ÇËSHTJE KUNDËR SHTETEVE TË TJERA

ÇËSHTJA NR. 1

Çështja:	Lakićević and Others v. Montenegro and Serbia
Link:	https://shorturl.at/nuGM8
E drejta dhe standardi i shkelur:	Shkelja e gëzimit qetësisht të pronës dhe shkelja e standardit nëpërmjet parimit të proporcionalitetit.

Përshkrim:

Katër aplikantët, të gjithë shtetas malazezë dhe avokatë në pension që marrin pensione, kanë vazhduar të punojnë me kohë të pjesshme në data të ndryshme midis 1996 dhe 2002, siç lejohej nga rregullat e atëhershme të pensionit në fuqi. Megjithatë, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor të vitit 2003, Fondi pensional mori një sërë vendimesh midis prillit 2004 dhe nëntorit 2005 duke pezulluar pagesën e pensioneve të tyre derisa në momentin kur ata të kishin ndërprerë aktivitetet e tyre profesionale. Këto vendime u konsideruan të zbatueshme që nga 1 janari 2004 dhe u mbështetën nga Ministria e punës dhe mbrojtjes sociale dhe gjykatat vendase.

Baza ligjore – neni 1 i protokollit nr.1

(a) Pranueshmëria – Meqenëse e gjithë procedura është zhvilluar ekskluzivisht brenda kompetencës së autoriteteve malazeze, të cilat gjithashtu kanë pasur kompetencë ekskluzive për t'u marrë me çështjen, aplikimet e aplikantëve kanë qenë në përputhje me Konventën dhe Protokollin nr. 1. Kjo vlen për Malin e Zi, por jo për Serbinë.

Përfundim: e pranueshme në raport me Malin e Zi, e papranueshme në raport me Serbinë (unanimisht).

(b) Bazueshmëria – Pezullimi i pagesës së pensioneve ndaj aplikantëve ka paraqitur ndërhyrje në gëzimin qetësisht të pronës së tyre. Duke pasur parasysh përfundimin mbi çështjen e proporcionalitetit (shih më poshtë), Gjykata nuk e ka konsideruar të nevojshme të vendosë nëse kjo ndërhyrje ka qenë e ligjshme. Ajo ka pranuar të ndjekë qëllimet legjitime të drejtësisë sociale dhe të mirëqenies ekonomike të shtetit.

Sa i përket proporcionalitetit, Gjykata ka vënë në dukje se, në përputhje me rregullat për pension të cilat në atë kohë kanë qenë në fuqi dhe të inkurajara nga sistemi i pensioneve ku ata kishin kontribuar për disa vite, ata kanë rihapur zyrat e tyre private me kohë të pjesshme, por duke vazhduar të marrin pension të plotë. Vendimi për pezullimin e pensioneve nuk është bërë për shkak të ndonjë ndryshimi në rrethanat e aplikantëve, por për shkak të ndryshimeve në ligj. Ai i ka goditur aplikantët në mënyrë të veçantë, pasi e ka pezulluar plotësisht pagesën e pensioneve që ata kishin marrë për disa vite e të cilat është dashur të përbënin një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të tyre mujore bruto. Për më tepër, aplikanti i parë, i dytë dhe i tretë gjithashtu janë detyruar të shlyejnë shumat që kishin marrë pas 1 janarit 2004. Kështu, aplikantët janë detyruar të mbanin barrë të tepruar dhe joproporcionale.

ÇËSHTJA NR. 2

ÇËSHTJA: ÇAKAREVIĆ V. CROATIA

Link:	https://shorturl.at/FMTU2
E drejta dhe standardi i shkelur:	<i>Shkelja e gëzimit qetësisht të pronës dhe shkelja e standardit përmes parimit të proporcionalitetit (shihet edhe qëllimi i mirë)</i>

Përshkrim:

Znj. Çakarevic u gjend e papunë në dhjetor 1995 dhe iu dha kompensim për papunësi Byroja kroate për punësim. Legjislacioni kroat , me të cilin janë rregulluar kompensimet për papunësi, ka paraparë se të papunësuarit që plotësojnë disa kriteret kanë të drejtë për kompensim të papunësisë, me kohëzgjatje maksimale 12 muaj. Megjithatë, Byroja kroate për punësim ka vazhduar t'ia paguajë përfitimet e papunësisë zonjës Çakareviq deri në mars 2001, kur e ka informuar se kompensimi i saj i papunësisë ishte pezulluar me efekt nga qershori 1998. Nga znj. Çakareviq u kërkua të shlyente afërsisht 2.600 euro (plus interes) për përfitimet e punësimit që ajo nuk kishte pasur të drejtë t'i marrë.

Znj. Çakarevic ankimoi këtë vendim, duke pretenduar e ka të drejtë për përfitime të papunësisë derisa të dalë në pension. Në lidhje me këtë çështje, GJEDNJ u përqendrua në ligjshmërinë e procedurës kundër znj. Çakareviq për shlyerje të borxhit ndaj qeverisë kroate, e jo në të drejtën e saj për vazhdim të përfitimeve për papunësi.

Arsyetimi ligjor – Vendim

Përfundimisht GJEDNJ ka vlerësuar nëse “pritshmëria legjitime” mund të ishte “posedim” ose “pronë”.

Gjykata gjeti disa faktorë që mbështesin argumentin se pritshmëria legjitime e znj. Çakareviq mund të konsiderohet si “posedim” në kuptimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1, sipas të cilit personat kanë të drejtë të marrin përfitime për papunësi: Znj. Çakareviq nuk ka kontribuar në vendimin e gabuar për të vazhduar marrjen e përfitimeve të papunësisë; Qeveria nuk e ka kontestuar vullnetin e mirë të znj. Çakareviq në marrjen e përfitimeve të kontestueshme për papunësi. Vendimi administrativ të cilit i është referuar znj. Çakareviq gjatë marrjes së pagesave nuk i referohej faktit se pagesat duhej të pushonin pas 12 muajsh; dhe se kishte kaluar një periudhë e gjatë kohore (mbi tre vjet) pas skadimit të periudhës së pagesës 12-mujore, gjatë së cilës autoritetet kanë vazhduar të paguajnë znj. Çakareviq, pa ngritur asnjë pyetje në lidhje me vlefshmërinë e pagesave.

Kështu, pasi ka vërtetuar se pritshmëria legjitime e znj. Çakareviq mund të konsiderohet pronë/posedim, GJEDNJ ka konstatuar shkelje të proporcionalitetit duke i kërkuar aplikantes të shlyejë një shumë, duke e vënë atë në një pozitë të palakmueshme të barrës individuale, kundrejt mbrojtjes të interesit publik.

ÇËSHTJA NR. 3

ÇËSHTJA: KJARTAN ÁSMUNDSSON V. ICELAND

Link	https://shorturl.at/nrtwE
E drejta, standardi dhe parimi i shkelur:	<i>Shkelja e gëzimit qetësisht të pronës, Shkelja e parimit të mosdiskriminimit, gjegjësisht barazisë dhe Shkelja e standardit nëpërmjet parimit të proporcionalitetit</i>
Përshkrim: <p>Rasti ka të bëjë me ndërhyrje diskriminuese në të drejtën e aplikantit për respektimin e pronës së tij.</p> <p>Pas një aksidenti industrial, në vitin 1978, aplikanti u vlerësua si 100% invalid dhe i paaftë për ta vazhduar punën si marinar, e kështu ka marrë pension invalidor. Në vitin 1992, mënyra e vlerësimit të aftësisë së kufizuar u ndryshua, në mënyrë që aftësia e kufizuar të mos vlerësohej më në aspektin e aftësisë për të kryer të njëjtën punë, por për të kryer punë në përgjithësi. Sipas kushteve të rregullave të reja, shkalla e aftësisë së kufizuar të aplikantit u rivlerësua në 25%, domethënë më pak se pragu minimal prej 35%. Në përputhje me rrethanat, pas një periudhe kalimtare prej 5 vjetësh, e drejta e aplikantit për një pension invalidori skadoi në vitin 1997.</p> <p>GJEDNJ konstatoi se rregullat e reja të pensionit ishin nxitur nga shqetësime të ligjshme dhe ishin bazuar në kritere objektive. Megjithatë, kjo rezultoi që aplikanti të privohej plotësisht nga pensioni i invalidor , i cili në atë kohë përbënte jo më pak se një të tretën e të ardhurave të tij mujore bruto dhe atë e kishte marrë për gati 20 vjet. Për më tepër, fakti që shumica dërrmuese e njerëzve që morën pensionet invalidore vazhduan të merrnin përfitime si më parë (megjithëse për disa me një normë të reduktuar), ndërsa një pakicë e vogël (54 persona, përfshirë aplikantin) humbën plotësisht të drejtën për një pension, u konsiderua si një trajtim diferencial. Kundrejt kësaj, GJEDNJ arriti në përfundimin se aplikanti është detyruar të mbajë një barrë të tepërt dhe joproporcionale (shkelje e nenit 1 të Protokollit nr. 1).</p>	

